

1 E mërkurë, 18 nëntor 2020

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes. Mirëserdhët të
7 gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Z. Sekretar, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Lënda KSC-
10 BC-2020-06, Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
11 Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Sekretar.

13 Tani do t'u kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
14 prezantohen. Do të filloj me Prokurorinë.

15 Urdhëro z. Prokuror, ose znj. Prokurore.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Mirëmëngjes të
17 gjithëve dhe atyre që na ndjekin me videolidhje.

18 Për Zyrën e Prokurorit të Specializuar të pranishëm sot
19 janë, Prokurori i Specializuar z. Jack Smith; Alan Tieger,
20 Prokuror i Lartë; prapa meje David Harbach; dhe në të djathtë,
21 Marlene Yahya Haage, që është përgjegjëse për procedurën e
22 nxjerrjes së materialeve; unë jam Clare Lawson.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Tani do t'i drejtohem Mbrojtjes. Do t'i drejtohem
25 mbrojtësve kryesorë dhe do të kërkoj prej atyre që të

1 prezantohet vetë dhe anëtarët e ekipit të tyre. Do të filloj
2 me avokatin e z. Thaçi, pastaj me të z. Veseli, pastaj të z.
3 Selimi, dhe pastaj të z. Krasniqi.

4 Do të filloj me mbrojtësin kryesor të z. Thaçi, z.
5 Hooper.

6 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Mirëmëngjes.
7 David Hooper, mbrojtësi kryesor. Dhe sot jam i shoqëruar nga
8 Dastid Pallaska, i cili është i pranishëm me videolidhje, dhe
9 me Sophie Menegon që është e pranishme fizikisht në sallë. Ju
10 faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Hooper.
12 Z. Emmerson, urdhëroni.

13 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Unë jam Ben
14 Emmerson në emër të Kadri Veselit. Unë përfaqësoj z. Veseli së
15 bashku me avokatin nga Kosova Kujtim Kabashi, i cili na ndjek
16 me videolidhje.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.
18 Urdhëroni z. Young.

19 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Unë jam David
20 Young, avokat i emëruar për Rexhep Selimin. Ndhmësi im do të
21 jetë Geoffery Roberts, dhe këshilltarë juridikë do të jenë dr.
22 Rudina Jasini dhe Furtuna Sheremeti. Ju faleminderit.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Young.
24 Dhe në fund fjalën e ka znj. Alagenda.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Unë jam

1 Venkateswari Alagendra për z. Krasniqi. E përfaqësoj së bashku
2 me bashkëmbrojtësin z. Aidan Ellis.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Për hir të procesverbalit, theksoj se z. Thaçi, z.
5 Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi, nuk janë fizikisht të
6 pranishëm në sallën e gjyqit, por janë të pranishëm përmes
7 videolidhjes. Dhe unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i
8 Procedurës Paraprake në këtë çështje.

9 Përpara se të vazhdojmë me rendin e ditës, do t'i kërkoj
10 palëve që të ndjekin rregullat për ecurinë të papenguar të
11 kësaj seance:

12 Ju lutem flisni ngadalë dhe qartë dhe prisni pesë sekonda
13 përpara se të përgjigjeni në ndonjë pyetje time apo një pale
14 tjetër, në mënyrë që përkthyesit të kenë kohë të përfundojnë
15 përkthimin.

16 Gjithashtu i informoj të gjithë se gjashtë avokatë
17 mbrojtës marrin pjesë në këtë seancë përmes videolidhjes. Në
18 mënyrë që të gjithë të mund të ndjekin procedurat, ju lutem të
19 mos flisni në të njëjtën kohë dhe prisni t'ju jepet fjala
20 përpara se të ndizni mikrofonin.

21 Jam i bindur se të gjithë ju tani dini për mbledhjet
22 përmes aplikacioneve Zoom, Skype apo Teams, por kjo është më
23 me rëndësi për kontekstin tonë sepse pjesëmarrësit marrin
24 pjesë në seancë si fizikisht po ashtu edhe me anë të
25 videolidhjes.

1 Nëse një palë ose pjesëmarrës do të marrë fjalën për të
2 ngritur një çështje apo të përgjigjet ndaj ndonjë parashtimi,
3 ju lutem të ngriheni në këmbë në qoftë se jeni në sallë ose të
4 ngrini dorën nëse jeni duke marrë pjesë përmes
5 videokonferencës.

6 Së fundi, lus ata që janë të pranishëm përmes
7 videolidhjes që në rast të një problemi teknik, të informojnë
8 menjëherë sekretarin ose të më informojnë mua duke ngritur
9 dorën. Nëse lidhja ndërpritet, do të përpigemi të rregullojmë
10 problemin teknik menjëherë. Në qoftë se ky problem teknik nuk
11 mund të zgjidhet menjëherë, atëherë mund të jetë e nevojshme
12 që të ndërpres seancën për disa minuta derisa të zgjidhet
13 problemi i lidhjes.

14 Tani do të kaloj në historikun procedural të çështjes.

15 Më 11 nëntor 2020, unë caktova datën për këtë seancë të
16 ecurisë së çështjes, dhe u kërkova palëve që të bëjnë
17 parashtime me shkrim për pikat në shtojcën e urdhrit tim për
18 caktimin e datën, për praktikën ose sistemin e redaktimeve që
19 do të ndiqet në këtë çështje, dhe për të gjitha temat e tjera
20 që vlerësohen të rëndësishme.

21 Prokuroria paraqiti parashtimet e veta të premtën e
22 kaluar, kurse ekipet e Mbrojtjes dje. Falënderoj të gjitha
23 palët për parashtimet e tyre me shkrim, pavarësisht afatit të
24 shkurtër për dorëzimin e tyre.

25 Qëllimi i seancës së sotme është të vlerësohet ecuria e

1 kësaj çështjeje dhe të organizohet shkëmbimi midis palëve në
2 mënyrë që të mundësohet përgatitje e shpejtë për gjykim.

3 Në veçanti, dua të diskutojmë deri ku është Prokuroria me
4 hetimet, numrin apo sasinë e përafërt të provave shkresore dhe
5 dëshmive që palët synojnë të paraqesin në gjykim, çështje në
6 lidhje me nxjerrjen apo dorëzimin e materialit mbështetës të
7 Aktakuzës, materialit shtesë që palët synojnë të përdorin në
8 gjykim, për materialin provues shfajësues dhe për materialin e
9 mbrojtur. Gjithashtu dua të diskutojmë për procedurën e
10 nxjerrjes së materialeve, për praktikën e redaktimeve që do të
11 ndiqet në këtë proces, dhe së fundi për çfarëdo pike tjetër që
12 palët mund të dëshirojnë të ngrenë.

13 Do t'i ftoj palët që t'i paraqesin mendimet e tyre në
14 mënyrë të përmbledhur për çdo pikë të rendit të ditës. Nuk ka
15 nevojë që palët të përsërisin atë që e kanë dhënë në
16 parashtrimet e tyre me shkrim. Gjithashtu dëshiroj t'i
17 informoj palët se versionin e redaktuar të Vendimit tim për
18 konfirmimin e Aktakuzës, do t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes
19 sot ose më sa largu në fund të kësaj jave.

20 Në këtë kontekst, informoj Mbrojtjen se në Vendimin tim
21 të Konfirmimit i dhashë Prokurorisë një afat prej një jave nga
22 data e Paraqitjes së Parë për të bërë kërkesa për masa
23 mbrojtëse në lidhje me materialin mbështetës, kështu që
24 redaktimet aktuale varen nga vendimi im për masa mbrojtëse.

25 Tani do të ftoj palët që të ndjekin rendin e ditës, dhe

1 do të filloj me pyetjet e përgjithshme.

2 Përpara se t'u jap palëve fjalën për pikat e
3 përgjithshme, dua që t'i përkujtoj ato për parimet e
4 përgjithshme të nxjerrjes së materialeve brenda kornizës
5 ligjore të Dhomave të Specializuara.

6 Nxjerrja e materialeve është proces midis palëve në
7 format elektronik, i organizuar dhe i lehtësuar përmes
8 sistemit të administrimit gjyqësor të Zyrës Administrative.
9 Nxjerrja e materialit duhet të jetë prioritet për Prokurorinë
10 në këtë fazë, kurse palët duhet të nxjerrin provat që janë me
11 të vërtetë të rëndësishme në çështje dhe jo pjesën më të madhe
12 të provave.

13 Duke marrë parasysh këtë parim, provat regjistrohen si
14 publike përveçse kur ka arsye për një klasifikim tjetër të
15 tyre. Nivelin e klasifikimit e përcakton pala.

16 Tani, do t'ia jap fjalën znj. Prokurore në lidhje me këtë
17 pikë të pyetjeve të përgjithshme.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar
19 Gjykatës.

20 Për sa i përket hetimeve, disa masa apo hapa hetimore
21 janë në vazhdim e sipër dhe një numër i këtyre hapave mund të
22 kryhen vetëm kur çështja të bëhet publike. Një shembull i
23 tillë është p.sh., kontrollimi që u bë gjatë arrestimit të të
24 akuzuarve. Një pjesë e materialeve që u morën gjatë këtij
25 kontrollimi, dhe ndoshta do të duhen hapa të tjerë hetimorë në

1 lidhje me atë material.

2 Prokuroria përpiket që procesi i nxjerrjes së materialeve
3 të kryhet në një mënyrë që nuk e paragjykon mbrojtjen. Ne kemi
4 caktuar një orar për përmbushjen e këtyre objektivave dhe do
5 ta informojmë Gjykatën dhe palët në mënyrën e duhur.

6 Për sa i përket mundësisë së ekipeve të Mbrojtjes që të
7 fillojnë me hetimet e tyre, brenda tre javëve që vijnë atyre
8 do t'u dorëzohet një vëllim i konsiderueshëm i materialeve që
9 përfshijnë materialet mbështetëse të Aktakuzës dhe mbi 1 000
10 materiale potencialisht shfajësuese. Të gjitha këto nxjerrje
11 materialesh do të diskutohet më me hollësi më vonë.

12 Për më tepër, vetë Aktakuza përmban pretendime të
13 detajuara lidhur me akuzat në këtë moment dhe duke u nisur nga
14 shkalla e hollësive për sa i përket aktakuzave në Aktakuzë,
15 duhet të bëhen edhe disa redakte. Dua t'ju konfirmoj se
16 synojmë që të ndjekim urdhrin tuaj për masa mbrojtëse.

17 Në pika të shkurtra, Mbrojtja ka informacion të bollshëm
18 për të filluar hetimet menjëherë. Ne ua kemi bërë të ditur
19 afatin e nxjerrjeve të materialeve. Për më tepër realiteti
20 është se nga informacioni që ka tani Mbrojtja, Mbrojtja është
21 e njoftuar me çështjen. Çështja nuk është një befasë për
22 Mbrojtjen dhe për mënyrën sesi do të paraqesin mbrojtjen e
23 tyre ekipet e ndryshme të Mbrojtjes.

24 Për mendimin e ZPS-së nuk ka asnjë arsye sepse kjo
25 çështje të mos -- gjykimi i kësaj çështje të mos mund të

1 fillojë në verën e vitin 2021.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit znj.

3 Prokurore.

4 Tani i drejtohem ekipeve të Mbrojtjes. Do të filloj me z.

5 Hooper. Urdhëroni.

6 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Në lidhje me

7 çështjen që po trajtojmë aktualisht dhe me komentin e fundit,

8 pra, se nuk duhet të jetë një befasi. Të gjithë nuk kemi

9 filluar me trajtimin e çështjes në kohën që ka filluar

10 Prokuroria dhe do të na duhet koha e nevojshme.

11 Prokuroria ka kryer hetime të gjata, për mendimin tim,

12 mbi pesë vjet, dhe ka pas në dispozicion materiale që janë

13 vënë -- prej hetimeve të tjera që janë kryer edhe shumë vite

14 më parë.

15 Dhe nga ana tjetër Prokuroria ka kryer funksionet e veta,

16 kryesisht para periudhës së KOVIDIT. Ne po jetojmë

17 momentalisht në një botë që ndikohet prej rrethanave të

18 KOVIDIT, dhe për mendimin tonë, kjo duhet të merret parasysh.

19 Dhe mendoj se të paktën 18 muaj do të na duhen përpara se të

20 mund të fillojmë edhe të mendojmë për fillimin e një gjykimi.

21 Për mendimin tim, propozimi që ky gjykim mund të fillojë

22 në qershor është absolutisht absurd. Kjo është një çështje e

23 komplikuar. Ndoshta do të fillojë në verë e në qershor, mirëpo

24 jo vitin e ardhshëm, ndoshta një vit më pas.

25 Ju thashë edhe njëherë se këto vlerësime të përafërta

1 janë diskutuar me kolegët e tjerë.

2 E dyta, për sa i përket Aktakuzës. Kur ke përpara një
3 Aktakuzë që është e redaktuar p.sh., një fjali kur thotë "në
4 një ditë" dhe nuk jepet dita apo data, kjo nuk është një
5 format adekuat. Me fjalë të tjera, redaktimi duhet të jetë në
6 shkallë më të vogël dhe materiali duhet të jetë i hapur për
7 Mbrojtjen.

8 Nga përvoja me çështje gjyqësore në Tribunalin e Hagës
9 dhe në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, këto janë mjaft detyra
10 të rëndësishme që kryhen nga oficerë përgjegjës, dhe si
11 rezultat kemi një defekt mjaft të madh për sa i përket
12 përshtatshmërisë së nxjerrjes së materialit.

13 Shpresoj që të gjejmë një zgjidhje lidhur me këtë
14 çështje. Ju faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

16 Z. Emmerson.

17 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] A mund të
18 shfrytëzoj këtë mundësi për t'u përgjigjur pyetjeve të
19 përgjithshme në shtojcën e Vendimit të Gjykatësit të
20 Procedurës Paraprake.

21 Së pari, për sa i përket afateve kohore të detyrimeve të
22 Prokurorisë gjatë fazës paraprake dhe hetimeve të Mbrojtjes.
23 Sigurisht që testi për këtë është mjaftueshmëria e kohës dhe e
24 mjeteve që u ofrohen të akuzuarve të përgatisin mbrojtjen. Nuk
25 ka një afat të përcaktuar kohor, po duhet ndërmarrë një qasje

1 e arsyeshme duke përdorur si udhëzues themelor të drejtën
2 themelore në nenin numër 6 të Konventës Evropiane për të
3 Drejtat e Njeriut. D.m.th., që duhet të ketë barazi armësh
4 midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes dhe nivel i përshtatshëm
5 proporcionaliteti, dhe Mbrojtja duhet të ketë kohë dhe mjete
6 të mjaftueshme për të shqyrtuar dhe për të përgatitur
7 mbrojtjen mbasi të kenë marrë hollësitë e akuzave në mënyrë që
8 të bëjnë një hetim efektiv.

9 Unë do të mendoja që këto parime themelore janë të
10 pakundërshtueshme, dhe u çuditëm dhe u zhgënjyem që Prokuroria
11 sugjeron në parashtimin me shkrim që gjyqi mund të fillojë
12 pak kohë mbasi të nxirren dokumentet e para. Dhe po kështu u
13 çuditëm dhe u zhgënjyem që avokatja e Prokurorisë u përpoq të
14 justifikonte që tani të akuzuarit i dinë akuzat që ka
15 paraqitur Prokuroria dhe që janë kundër tyre.

16 Ky është një pozicion i jashtëzakonshëm që ndërmer
17 Prokuroria, sidomos duke pasur parasysh sesa të rëndësishme
18 dhe sa të rënda janë akuzat që janë bërë. Pra, është një
19 indikacion kjo sesa të singertë janë Prokuroria në qasjen e
20 tyre.

21 Tani, pasi kam thënë këtë, është e qartë, bazuar në
22 përvojat e gjykimeve në Tribunalin Penal për ish-Jugosllavinë
23 që janë marrë me Kosovës dhe me akuzat për ndërmarrje
24 kriminale të përbashkët kundër anëtarëve të UÇK-së, që gama
25 dhe natyra e hetimeve që kërkohet të bëhen nga Mbrojtja, do të

1 jenë mjaft të mëdha. Dhe këto do të jenë të shumta dhe të
2 mëdha sepse Aktakuza e Prokurorisë është ndërtuar si me arna.
3 Janë bashkuar disa akuza të ndryshme nga zona të ndryshme të
4 Kosovës, janë përmendur shumë emra njerëzish, dhe njerëz të
5 ndryshëm që pretendojnë se kanë qenë anëtarë të UÇK-së kanë
6 sajuar të gjitha këto akuza dhe janë bashkuar të gjitha ato në
7 këtë ndërmarrje të përbashkët kriminale që paraqet Prokuroria.

8 Pra, nga kjo përvojë e mëparshme në Tribunalin e
9 Jugosllavisë, kjo tregon se -- na ka treguar se mund të ketë
10 prova false që janë paraqitur në shumë raste nga Prokuroria.
11 Ndoshta Prokuroria nuk e di që ato kanë qenë false, megjithatë
12 ne na duhet të bëjmë një ekzaminim forenzik të fakteve të
13 provave që paraqit Prokuroria.

14 Pra, që të dëgjojmë nga avokatja e Prokurorisë që çohet
15 aty dhe thotë që Mbrojtja e di se cilat janë akuzat kundër të
16 akuzuarve, kjo është tronditëse. Realiteti është që pasi ne të
17 njihemi me akuzat që janë paraqitur kundër nesh, do të na
18 duhen 18 muaj minimum hetime.

19 Këtë vlerësim nuk e kemi nxjerrë nga mendja jonë. Është
20 mbi bazën e gjykimeve të mëparshme në Tribunalin e Hagës, ku
21 janë bërë gjyqe për anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
22 që kishin një model të njëjtë po që ishin shumë më të ngushta
23 në gamën, në fushëveprimin e tyre.

24 P.sh., ne propozojmë hetime që të bëhen nga hetues
25 ndërkombëtarë shumë me përvojë, të cilët do t'i kalojnë akuzat

1 një nga një dhe do t'i hetojnë ato një nga një, dhe do t'i
2 bëjnë këto hetime në mënyrën sesi i kërkon çfarëdo mbrojtësi
3 në këtë rast.

4 Pra, kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Dhe siç
5 tha z. Hooper, Prokuroria ka pasur pesë vjet që t'i hetojë
6 këto çështje, ka pasur burime të pakufizuara dhe Gjykatësi i
7 Procedurës Paraprake duhet të vendosë balancën këtu dhe që
8 palët të mos zhgënjehen nga kjo mungesë proporcionaliteti. Dhe
9 nuk duhet bërë sugjerimi që nuk ka nevojë për hetime nga ana e
10 Mbrojtjes. Kjo është krejtësisht e gabuar.

11 Pra, ne e mbështesim sugjerimin e z. Hooper që gjyqi nuk
12 ka sesi të fillojë përpara qershorit të vitit 2022. Kjo është
13 më e hershmja që mund të fillojë. Unë mendoj madje realisht që
14 nuk mund të fillojë as atëherë, sepse ndonjëherë gjërat nuk
15 shkojnë ashtu siç planifikohen. Por edhe sikur t'i përmbahemi
16 programit dhe agjendës që i kemi vendosur vetes, d.m.th.,
17 mbasi Prokuroria t'i ketë plotësuar detyrimet e veta, do të
18 ngelen muaj të tërë, pra, 18 muaj menjëherë mbasi të bëhet
19 dorëzimi i materialeve nga Prokuroria që ne të bëjmë hetimet
20 tona.

21 Për sa i përket kohëzgjatjes së gjyqit, duke pasur
22 parasysh se kemi rreth 200 dëshmitarë dhe flitet për më shumë
23 100 incidente në të gjithë territorin e Kosovës dhe një pjesë
24 të Kosovës, ne mendojmë që gjyqi do të vazhdojë 18 muaj deri
25 në 2 vjet. Megjithatë, e theksoj edhe njëherë që jam i

1 zhgënjyer nga qëndrimi i Prokurorisë.

2 Tani desha t'i kthehem që çështjeje tjetër të
3 përgjithshme që është -- i përgjigjet pyetjes 1(e) në pyetjet
4 e përgjithshme të Gjykatës, që kanë të bëjnë me çështje që
5 janë specifike për Mbrojtjen ose që kanë të bëjnë me arsye të
6 tjera për përjashtimin e përgjegjësisë penale.

7 Ne rezervojmë pozicionin tonë për pasoja të caktuara,
8 p.sh., si alibia, deri sa të dimë në detaje se cilat janë
9 akuzat që po bëhen kundër nesh. Pra, ne nuk jemi në gjendje
10 t'i përgjigjemi derisa të kemi hollësitë. Dhe kur them
11 "hollësitë", hollësi të mjaftueshme në formë të paredaktuar.
12 Pra, në lidhje me alibinë ose me çështjet e alibisë dhe
13 çështje të tjera të mbrojtjes afirmative, ne rezervojmë
14 pozicionin që të bëjmë nxjerrjen e pozicionit tonë,
15 parashtrimin e pozicionit tonë në kohën e duhur dhe në mënyrën
16 e duhur.

17 Megjithatë, në emër të z. Veseli desha të paraqes edhe
18 disa arsye të tjera që përjashtojnë përgjegjësitë penale që
19 janë përmendur nga Prokuroria, kur ajo foli për atë që ne e
20 dimë se çfarë akuzash janë ngritur kundër nesh.

21 Të shpjegoj se cilat janë këto çështje. E para, ata së
22 pari thonë që nuk ka nevojë për hetime, kurse ne themi që
23 hetimi është shumë i rëndësishëm dhe është qendror për të
24 trajtuar të gjitha temat.

25 Pika e parë: Në qoftë se Prokuroria është në gjendje të

1 provojë kryerjen e krimeve nga individë që kanë qenë anëtarë,
2 ose pretendonin të ishin anëtarë të UÇK-së gjatë periudhës së
3 Aktakuzës, akumulimi i këtyre krimeve individuale nuk përbën
4 ndërmarrje kriminale të përbashkët. Nuk ka ekzistuar
5 ndërmarrje kriminale e përbashkët ashtu siç përcaktohet në
6 Aktakuzë dhe nuk ka baza të tjera ligjore për ta quajtur z.
7 Veseli përgjegjës për aktet kriminale të të tjerëve.

8 Së dyti: Në aplikimin e -- në zbatimin e të Drejtës
9 Penale Ndërkombëtare konteksti është çdo gjë. UÇK-ja ka qenë
10 një lëvizje, kryengritje popullore spontane dhe e organizuar
11 në mënyrë minimale për të mbrojtur popullatën civile nga
12 gjenocidi dhe kriminelët serbë. Më shumë se 10.000 civilë
13 kosovarë shqiptarë janë vrarë nga forcat e kombinuara serbe në
14 masakra të planifikuara dhe vendi u përfshi nga kaosi dhe nga
15 dhuna që përbën gati luftë civile. Shqiptarët u varrosën nëpër
16 varre masive nga forcat serbe dhe shumë pastaj u zhvarrosën,
17 dhe ka shumë të tjerë të cilët -- trupat e tyre gjenden në
18 Serbi dhe janë fshehur atje, janë çuar me kamion dhe janë
19 varrosur atje.

20 Tribunali i Hagës, ai që u ngrit për të trajtuar krimet e
21 atij konflikti, ka dënuar gjashtë eprorë të lartë të Ushtrisë
22 dhe Policisë Serbe, të cilët kishin për qëllim të pastronin
23 etnikisht Kosovën nga popullata civile shqiptare përmes
24 kryerjes së krimeve kundër njerëzimit ndaj popullatës
25 shqiptare dhe duke i dëbuar ata në vendet fqinje, në Maqedoni,

1 në Shqipëri dhe Mal të Zi.

2 Të pretendosh se ka një barazi, mund të vihet shenja e
3 barazisë midis këtij lloj konspiracioni kriminal dhe veprimeve
4 të gabuara nga disa anëtarë të UÇK-së, është shumë e gabuar.
5 Kur të dalin në pah provat që ka Prokuroria, kjo Aktakuzë do
6 të quhet qesharake.

7 Së treti: Në kontekstin e një sulmi të koordinuar dhe të
8 vazhdueshëm nga forcat profesionale serbe dhe të ish-
9 Jugosllavisë, shqiptarët e Kosovës u përpoqën të organizohen
10 fshat pas fshati në një formë të organizuar po sporadike dhe
11 të shkëputur për të mbrojtur komunitetet e tyre brenda
12 fshatrave të tyre. Ky ishte një akt rezistence, dhe sigurisht
13 në këtë kontekst mund të jenë kryer disa krime individuale nga
14 anëtarë individualë të UÇK-së. Dhe këto krime sigurisht,
15 secili prej tyre kanë qenë të pajustificueshëm, por këto janë
16 krime individuale në një shkallë minore, shumë të vogël në
17 krahasim me shkallën industriale dhe kasaphanën sistematike që
18 u ushtrua mbi shqiptarët nga Jugosllavia.

19 D.m.th., e vetmja ndërmarrje kriminale e përbashkët që
20 ekzistonte, ishte ajo që ishte për të mbrojtur popullatën
21 civile nga krimet që po kryheshin nga regjimi jugosllav.

22 D.m.th., objektivi i tyre nuk ishte kryerja e krimeve kundër
23 civilëve, është e kundërta e vërteta, ata arritën fitore
24 modeste dhe vetë ekzistenca e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
25 varej nga mbështetja që i dha populli i Kosovës. Pra, këta nuk

1 kishin shpresë që mund të arrinin këtë në fakt, në qoftë se
2 nuk do të ishin mbështetur nga popullata dhe në qoftë se do të
3 kishin krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

4 Këta drejtues, të ashtuquajturit që rrinë -- janë sot në
5 bankën e të akuzuarit, ishin njësoj si individët e tjerë në të
6 gjithë Kosovën, gra dhe burra të cilët një ditë vendosën të
7 bashkohen me këta. Këta ishin bujq, ishin vullnetarë, vinin
8 nga të gjitha anët e vendit dhe kishin një qëllim të
9 përbashkët, të mbronin veten dhe komunitetin e tyre.

10 Pika e katërt: Qëllimi i përbashkët, që pretendohet nga
11 Prokuroria, është trajtuar në mënyrë të gjerë në këtë kontest
12 gjatë dy gjyqeve të mëparshme kundër anëtarëve të UÇK-së në
13 Tribunalin e Hagës. Tribunali i Hagës e ka pranuar më parë që
14 në kontestin e UÇK-së, një akumulim i krimeve individuale
15 gjatë periudhës së Aktakuzës nuk mund të barazohet me
16 ndërmarrje të përbashkët kriminale. Nuk është çështje që të
17 gjesh ca krime individuale dhe pastaj të gjesh kush e ka fajin
18 për ato krime individuale. Edhe nuk mund të bëhet konkluzioni
19 për ekzistencën e ndërmarrjes kriminale të përbashkët thjesht
20 me anë të inferencës. Z. Veseli mbështetet në këto aktgjykime
21 të mëparshme si konkluzione bindëse.

22 Dhe pika e fundit që dua të ngre është, që pa pikë
23 dyshimi organizimi operativ dhe linjat e autoritetit në
24 komunikim midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës -- anëtarëve të
25 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në periudhën e Aktakuzës, ishin

1 kaq të fragmentuara dhe rudimentare, sa ishte e pamundur të
2 provohet që ekziston bazë ligjore për të justifikuar
3 mbështetjen e Prokurorisë në këtë doktrinë të komandës dhe
4 përgjegjësisë.

5 Ky pozicion është pranuar nga Prokuroria në procedurat
6 para Tribunalit të Hagës pas një hetimi mjaft të gjatë dhe të
7 thelluar. Nuk është bërë atje asnjë akuzë për përgjegjësi
8 komanduese, sepse nuk ishte e mbështetshme dhe ishte
9 jorealiste të mbështeteshë mbi ato fakte në lidhje me
10 defiçienat organizative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
11 dhe këto defiçienca nuk e bënë atë në gjendje që të kishte --
12 që Prokuroria të ndërtonte një akuzë për përgjegjësi
13 komanduese.

14 Këto janë çështjet që desha të ngre unë sot.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emerson.

16 Tani z. Young.

17 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Përshëndetje.

18 Unë jam plotësisht dakord me z. Hooper dhe z. Emerson, dhe
19 për këtë arsye në fakt do të flas shkurtimisht.

20 Shkurtimisht, më duhet të them që parashtimet e
21 Prokurorisë janë shumë zhgënjyese dhe janë sinqerisht edhe
22 absurde. Këto parashtime nuk kanë -- marrin fare parasysh të
23 drejtën e të akuzuarit për proces të ndershëm dhe të drejtë
24 gjyqësor, dhe afati kohor i cili u parashtua nga Prokuroria e
25 tregon këtë gjë.

1 Prokuroria mbase mund të ketë pasur pesë vjet apo dhjetë
2 vjet, ose Zoti e di sesa vite ka pasur, të paktën pesë vite më
3 duhet të them, por unë vetë kam arritur këtu në Hagë vetëm një
4 javë më parë. Dhe ndërkohë çuditërisht edhe sesi Prokuroria mendon
5 që të akuzuarit -- mund të prisnin që aktakuzat e ngritura
6 kundër tyre do të konfirmoheshin.

7 Kështu që, me respekt, më duhet të them që afatet kohore
8 të sugjeruara nga Prokuroria janë absolutisht të papranueshme.
9 Ne duhet të kemi kohë të mjaftueshme për të përgatitur, për të
10 bërë hetimet tona, si dhe për të kryer dhe hetime të
11 thelluara. Dhe për këtë arsye na duhet kohë e mjaftueshme dhe
12 një kalendar pune që duhet të jetë i arsyeshëm. Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.
14 Young.

15 Znj. Alagendra.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Të
17 nderuar, neve e dëgjuam atë çfarë kishte për të thënë
18 Prokuroria. Prokuroria tha që Mbrojtja është e gatshme, ose
19 duhet të jetë e gatshme që t'i fillojë tani, sot, këto hetime
20 apo procedura. Ndërkohë ne nuk jemi fare dakord me
21 parashtrimet e Prokurorisë. Jam plotësisht dakord me
22 parashtrimet e kolegëve të mi, të z. Hooper, z. Young, z.
23 Emmerson.

24 Sipas mendimit tonë, koha më e shpejtë kur mund të
25 fillojnë hetimet është pasi të jetë arritur progres

1 substancial thelbësor nga ana e Prokurorisë sa i takon
2 nxjerrjes së materialeve.

3 Lidhur me përgatitjen e çështjes, më duhet të them që ne
4 na duhet kohë e mjaftueshme dhe po ashtu edhe mjete të
5 mjaftueshme. Dhe të mjaftueshme, të përshtatshme, adekuate,
6 pra, duhet që të bëhet vlerësimi i kësaj fjale në kuadër të
7 rrethanave aktuale. Pra, të situatës së KOVIDIT, po gjithashtu
8 duke marrë parasysh edhe kohën që ka pasur parasysh Prokuroria
9 për të nxjerrë dhe për të bërë Aktakuzën kundër katër të
10 akuzuarve.

11 Për momentin kaq kam për të thënë lidhur me hetimet.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

13 Alagendra.

14 Tani fjalën e ka Prokuroria. Nuk e di në qoftë se
15 Prokuroria ka ndonjë gjë për të shtuar pasi dëgjuan
16 parashtrimet e Mbrojtjes?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, faleminderit Gjykatës. Shumë
18 shkurtimisht.

19 Mendoj që parashtrimi im ishte shumë i qartë. Ne nuk po
20 sugjeronim që nuk duhet ose nuk është i nevojshëm hetimi nga
21 ana e Mbrojtjes, në të kundërtën, është i nevojshëm një hetim
22 i detajuar dhe i kujdesshëm prej Mbrojtjes. Por parashtrimi
23 ynë thoshte që Mbrojtja duhet që të ketë mundësi që të fillojë
24 nga hetimet sa më shpejt të jetë e mundur.

25 Pra, sa i takon Mbrojtjes së z. Veseli, që tha që është e

1 pamundur që të bëhet kjo gjë menjëherë, më duhet të them që në
2 përgjigje të Prokurorisë ne kemi marrë shënim të gjitha pikat
3 të cilat u ngritën nga Mbrojtja e z. Veseli, dhe padyshim që
4 do të diskutojmë në më tepër detaje për sa i takon provave
5 konkrete të përfaqësuara gjatë procesit gjyqësor.

6 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit Prokuroria.

7 Nuk e di në qoftë se ndonjë nga palët në këtë proces do
8 të duan që të thonë diçka tjetër. Në qoftë se jo, do të
9 kalojmë në një pikë tjetër të agjendës.

10 Para se ta bëj këtë gjë, do të dua që të përmend për
11 publikun se sot nuk do të përcaktohet data për fillimin e
12 procesit, megjithatë mund të shënojmë që në momentin kur -- sa
13 më shpejt të mund të përfundojë procesi i nxjerrjes së
14 informacionit dhe i dokumentacionit nga Prokuroria, aq më
15 herët, aq më shpejt do të vijohet me punën e Mbrojtjes edhe aq
16 më shpejt ne mund të vijojmë me vazhdimësinë e progresit,
17 d.m.th., sa më shpejt të japë dokumentacionin Prokuroria aq më
18 mirë do të jetë për të gjithë procedurën.

19 Kalojmë në pikën e dytë të programit për sot, që është
20 materiali mbështetës për Aktakuzën.

21 Dua t'i kujtoj Prokurorisë se brenda 30 ditësh nga
22 Paraqitja e Parë, të gjitha materialet mbështetëse për
23 Aktakuzën dhe të gjitha deklaratat e të të akuzuarve duhet që
24 t'i bëhen të disponueshme, pra, t'i vihen në dispozicion
25 Mbrojtjes.

1 Dhe për këtë arsye neve e planifikuam këtë Konferencë për
2 Gjendjen e Lëndës sot dhe jo në fund të nëntorit, siç u kërkua
3 prej disa prej avokatëve mbrojtës të të akuzuarve.

4 Ftoj që Prokuroria të japë parashtrimin e vetë sa i takon
5 nxjerrjes së materialit mbështetës. Por përpara kësaj do të
6 doja që t'i referohesha z. Young, parashtrimin të z. Young, sa
7 i takon mospërputhjes ndërmjet numrit të dëshmitarëve që
8 referohet nga Prokuroria për qëllimet e Aktakuzës së
9 Konfirmuar, që është 153, dhe numrit 130 që referohet nga --
10 në dokumentacionin tjetër. Dhe po ashtu do të doja që t'i
11 jepja mundësinë Prokurorisë që të mund të bënte dhënien apo të
12 nxirrte informacionin në mënyrë të vijueshëm.

13 Mbështetur në Rregulloren, në rregullën 102(1)(a), numri
14 i konsiderueshëm i deklaratave të dëshmitarëve që do të duhet
15 që të jepen, të nxirren, dhe duke pasur parasysh gjithashtu
16 edhe punën e jashtëzakonshme të Prokurorisë për të bërë
17 redaktimet dhe për -- dhe të drejtën e Mbrojtjes për të marrë,
18 për të përtypur, për të analizuar provat e zbuluara, do të
19 doja të dija në qoftë se do të jetë e mundur që të mund të
20 përcaktojmë një afat kohor për nxjerrjen e materialeve që do
21 të bëjë të mundur nxjerrjen graduale të materialeve?

22 Dhe në mënyrë që të mund të fillojmë, le të themi përpara
23 afatit kohor 30-ditor, nuk e di në qoftë se Prokuroria ka
24 nevojë për disa ditë pas 30-ditorëshit që është afati kohor,
25 në mënyrë që të mund të përfundohet me nxjerrjen e

1 informacionit apo të materialeve që parashikohen në rregullën
2 102(1) (a)?

3 D.m.th., këto janë pyetje specifike që do të doja që të
4 trajtoheshin nga palët në parashtimet e tyre tani.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Materiali i Aktakuzës i
6 Prokurorisë përfshin shumë çështje, 1.842 zëra. Një pjesë e
7 tyre është në trajtën e deklaratave. Kemi 153 dëshmitarë. Një
8 pjesë e tyre janë në pjesën e zbardhjes së transkripteve.
9 Kështu që këtë kisha për të thënë sa i takon ngarkesës së
10 materialeve.

11 Përkthimi i materialeve mbështetëse të Aktakuzës në shqip
12 ka filluar në mënyrë të vazhdueshme që në ditën e dhënies së
13 Aktakuzës dhe është një proces i cili vazhdon edhe teksa
14 flasim. Pavarësisht nga kjo, ne parashikojmë që të kemi
15 përkthime të plota të disponueshme brenda afatit 30-ditor.

16 Për veç kësaj, i nderuar Gjykatës, Prokuroria kërkon masa
17 mbrojtëse për disa dëshmitarë dhe viktimë të identifikuar në
18 materialet mbështetëse, edhe parashtimi për këtë çështje do
19 të dërgohet gjatë kësaj jave përpara Gjykatës.

20 Sa i takon afatit kohor për nxjerrjen e materialit, nuk
21 mendoj se ka ndonjë dallim në parim ndërmjet Prokurorisë edhe
22 Mbrojtjes. Siç është thënë edhe në parashtimet tona, neve do
23 të nxjerrim materiale që parashikohen në rregullën 101(2) (a),
24 sapo ta kemi mundësinë ta bëjmë këtë gjë. Megjithatë, më duhet
25 të them që në këtë rast, "sa më shpejt të jetë e mundur"

1 d.m.th., nuk mund të identifikohet ose nuk mund të
2 përkufizohet më përpara sesa afatit kohor prej 30 ditësh. Në
3 këtë kohë, ajo çfarë na mbetet si një afat kohor i parashikuar
4 për këtë proces është tre javë.

5 Neve kemi bërë përgatitje për këtë nxjerrje prej disa
6 muajsh, por siç e theksuat edhe ju i nderuar Gjykatës, bëhet
7 fjalë për një volum shumë të madh materialesh dhe bëhet fjalë
8 për faktorë shumë praktikë dhe logjistikë që kanë ndikim mbi
9 elementin kohë. Këto hapa nuk do të mund të ishin marrë, dhe
10 siç e thashë, është shumë e rëndësishme po ashtu që të vëmë --
11 të kemi parasysh edhe nevojën e ndërmarrjes së masave
12 mbrojtëse.

13 Ndërkohë që jo i gjithë materiali kërkon redaktim,
14 pavarësisht kësaj, duhet tre njerëz dy ditë të plota që të
15 mund të përgatisin një paketë zbulimi, nxjerrje informacioni
16 të një përmase - flas këtu për informacion të arsyeshëm. Dhe
17 në këtë rast p.sh., do të na duheshin katër deri në gjashtë
18 ditë pune në mënyrë që të mund të jepnim informacione për
19 nxjerrjen e materialeve, gjë e cila mbase mund të cenonte le
20 të themi, aftësinë tonë për të realizuar afatin kohor prej 30
21 ditësh.

22 Dhe nga Prokuroria mund t'ju them që përkufizimi "sa më
23 shpejt të jetë e mundur", për neve interpretohet si brenda 30
24 ditësh siç lejohet dhe siç parashikohet në rregullat
25 përkatëse.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

2 Pra, do të doja t'ju pyesja lidhur me të atë çfarë thashë
3 edhe më përpara. A do t'ju ndihmonte në qoftë se do të merrnit
4 pak ditë pas 30 ditëve, që është afati kohor i parashikuar, në
5 mënyrë që të mund të vijoni me procesin e nxjerrjes së
6 informacionit? Kjo është sugjeruar nga Mbrojtja. D.m.th., do
7 t'ju ndihmonte në qoftë se do të kishit dy, tre ditë më shumë
8 përtej këtij afatit kohor 30-ditorë të parashikuar?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Çdo zgjatje e afatit kohor mbi 30
10 ditë do të na ndihmonte. Megjithatë referenca, ose le të
11 themi, shtesa e pak ditëve plus këtyre 30 ditëve që
12 parashikohen, nuk është se do të ndihmonte shumë sa i takon
13 avancimit ose progresit në këtë drejtim.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë znj.
15 Lawson.

16 Tani skuadrat e Mbrojtjes.

17 Z. Hooper, fjala për juve.

18 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk kam shumë
19 përgjigje për çështjet e ditës së sotme.

20 Por ajo çfarë do të them është kjo: Nxjerrja e
21 dokumentacionit shihet si vënie në lëvizje e hetimeve. Në fakt
22 nuk është kështu, sepse ne kemi një sasi të konsiderueshme
23 materialesh që duhet ta trajtojmë, dhe është e nevojshme që ne
24 ta përpijmë, ta përvetësojmë, ta asimilojmë, ta analizojmë, në
25 mënyrë që të mund të vijojmë më tej me hetimet.

1 Dhe për këtë arsye nuk duhet të keni këtë idenë që në
2 momentin kur të bëhet informacioni i ditur, kur të nxirret
3 dokumentacioni ose informacioni, atëherë mund të fillosh
4 menjëherë nga ana e Mbrojtjes që të merresh me hetimet. Nuk
5 është ky rasti në fakt.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.
7 Z. Emerson.

8 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar,
9 dua ta bëj të qartë se ne e kuptojmë që Prokuroria ka një
10 material të konsiderueshëm për të kaluar dhe për të punuar,
11 dhe i kuptojmë gjithashtu edhe detyrimet për nxjerrjen e
12 dokumentacionit janë të shumta. Dhe i kuptojmë gjithashtu edhe
13 proceset e përkthimit edhe të redaktimit të cilat duan kohën e
14 tyre, por thjesht sa i takon afatit kohor prej 30 ditëve - nuk
15 e di në qoftë se janë në të njëjtën mendje gjithashtu edhe
16 kolegët e tjerë të Mbrojtjes - por po flasim për çështje
17 ditësh. Dhe çështja është që në momentin kur informacioni të
18 nxirret, dokumentacioni të nxirret, ai të jetë në një format
19 të tillë ku ne mund të punojmë.

20 Kështu që pyetja që kam unë është që Mbrojtja, ose
21 çështja që kam unë është që Mbrojtja nuk duhet të çohet në
22 pozicionin që të dalë herë pas herë te Gjykatësi i Seancës
23 Paraprake, siç ka ndodhur në procese të mëparshme gjyqësore,
24 në mënyrë që të mund të trajtohet kjo çështje, pra, të ketë
25 dokumentacionin e nevojshëm për të bërë hetimet e nevojshme.

1 Pra, është Prokuroria ajo që bën redaktimin si hap i
2 parë, si nivel i parë, dhe ne, pra, nuk duhet të vihem i në
3 vështirësi sepse një gjë e tillë, në qoftë nuk e marrim
4 dokumentacionin në formatin e duhur atëherë kjo do të çonte në
5 vonesën e proceseve.

6 Dhe unë nga ana ime, po mendoj që edhe kolegët e mi, sa i
7 takon pjesës së procedurës jemi në pozicion të tillë, që i
8 takon Prokurorisë që të bëjë pjesën e realizimit të detyrimeve
9 për zbulimin, nxjerrjen e informacionit dhe që të parashikojë
10 apo të bëjë një lloj udhërrëfyesi për procesin që duhet të
11 ndiqet më pas.

12 Unë nuk është se do të bëj ndonjë parashtrim sa i takon
13 propozimit të bërë prej tyre. Unë do të pres për të parë së
14 pari në qoftë se afatet kohore do të respektohen prej tyre.
15 Dhe ndërkohë përvoja tregon, thuajse në çdo rast, fatkeqësisht
16 kështu, që realitetet nuk përkojnë me pritshmërinë e
17 procedurave të cilat përcaktohen në fillim të seancave
18 gjyqësore.

19 Edhe prandaj për këtë arsye është shumë e rëndësishme që
20 secila prej palëve të bëjë punën e vetë në mënyrë të tillë që
21 mund të shkojë sa më pa problem procesi. Pozicioni ynë është
22 që të shohim sesi ky plan do të fillojë dhe të zbulohet apo të
23 realizohet. Dhe të shohim sesa praktik edhe sa i drejtë është
24 ai, dhe të shikojmë se çfarë do të bëhet në Konferencën tjetër
25 për Statusin ose gjendjen gjyqësore.

1 Do të doja të them që këtu në këtë konferencë, Konferencë
2 për Procesin ose gjendjen gjyqësore, Prokuroria thotë që çdo
3 shtesë mbi afatin kohor 30-ditor do ta ndihmonte. Dhe kjo
4 nënkupton mbase nga ana e Prokurorisë, që mund të ketë mangësi
5 në qoftë se parashtimet do të bëhen brenda afatit 30-ditor.

6 Kjo është parashtresa ime.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani fjalën e ka z. Young.

8 Faleminderit z. Emmerson.

9 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Shumë shkurt.
10 Faleminderit znj. Prokurore, që na e qartësuat dhe që na thatë
11 që kishte mospërputhshmëri, ose konfirmuat përputhshmëritë --
12 mospërputhshmëritë në shifra. Gjëra të tilla mund të ndodhin.
13 E vlerësojmë që Prokuroria ka një përgjegjësi të
14 jashtëzakonshme duke marrë parasysh përmasat dhe madhësinë e
15 lëndës.

16 Nuk dua të bëj parashtresa të tjera për momentin, por
17 thjesht do të doja të thosha diçka lidhur me procedurën për
18 nxjerrjen e materialeve, por këtë gjë do ta bëj pak më vonë,
19 jo tani.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

21 Kam përshtypjen që në parashtimet me shkrim z. Young,
22 keni kërkuar që nxjerrja e dokumentacionit të fillojë përpara
23 afatit kohor prej 30 ditësh, sepse edhe e keni ngritur në fakt
24 këtë si një çështje shumë të rëndësishme, prandaj unë kërkoja
25 ose propozova që të mund të bëhej zbulimi, nxjerrja e

1 informacionit me dosje ose gradualisht, edhe prandaj shtova
2 edhe propozimin që ndoshta t'i japim edhe disa ditë më tepër
3 Prokurorisë që të përmbushte detyrimet e saj.

4 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
5 Gjykatës, siç e tha edhe z. Emmerson, në skemën apo në
6 panoramën e përgjithshme të gjërave, nuk mendojmë që pak ditë
7 më shumë mund të prishte punë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Tani kohën e ka -- fjalën e ka znj. Alagendra.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Edhe ne kërkojmë që nxjerrja e informacionit të fillojë
13 sa më shpejt të jetë e mundur dhe gradualisht, në mënyrë që
14 neve të mund të na vihet në dispozicion informacioni që është
15 i disponueshëm nga ana e Prokurorisë sa më shpejt të jetë e
16 mundur.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
18 Alagendra.

19 Tani më lejoni sërish t'i jap fjalën Prokurorisë. Dhe do
20 të shtoja që p.sh., në qoftë se do të kishit dy javë të tjera
21 për detyrimin për nxjerrjen e materialeve, a do t'ju ndihmonte
22 kjo gjë, në qoftë se do të shtonim dy javë të tjera plus
23 afatit të parashikuar?

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, pozicioni ynë
25 është që aktualisht ne parashikojmë që të përmbushim afatin

1 kohor prej 30 ditësh, edhe preferojmë ta bëjmë këtë gjë në
2 fakt. Edhe nuk kam asgjë tjetër për të shtuar lidhur me këtë
3 çështje.

4 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

5 Në qoftë se ndonjë prej mbrojtësve nuk ka ndonjë gjë për
6 të shtuar - nuk më duket sikur ndonjëri prej tyre do të marrë
7 fjalën - mund të vijojmë me pikën tjetër në agjendë, që janë
8 materialet e tjera shtesë të cilat synojnë që të përdoren ndaj
9 Gjykatës, që është pjesë e rregullës 102(1)(b).

10 Pra, e njoh, e pranoj që Prokuroria synon që të më japë
11 informacione të mëtejshme, të nxjerrë informacione të tjera të
12 cilat janë të parashikuara në rregullën 102(1)(b). Dhe një gjë
13 të tillë e parashikon që t'ua vërë në dispozicion Mbrojtjes
14 deri më 31 maj 2021, ose 30 ditë përpara hapjes së çështjes së
15 Prokurorisë.

16 Dua të ftoj Prokurorinë që të shtjellojë, të eksplorojë
17 mundësinë e nxjerrjes së materialeve në mënyrë graduale,
18 p.sh., çdo muaj, në mënyrë që Mbrojtja, që ekipet e Mbrojtjes
19 të mund të njihen me dokumentacionet përkatëse. Pra, është më
20 mirë që informacionet të jepen në mënyrë graduale sesa të
21 jepet një i tëri në fund.

22 Znj. Lawson.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sa i takon materialeve, ne do të
24 mbështetemi në proceset gjyqësore. Dhe sa i takon mbështetjes
25 te shumica e 153 dëshmitarëve, sërish ka prova të cilat janë

1 dhënë gjithashtu dhe te pjesa e konfirmimit të Aktakuzës, dhe
2 Prokuroria parashikon që të mbështetet te rreth 50 dëshmitarë
3 të tjerë shtesë.

4 Sa i takon provave shkresore, dokumentare, Prokuroria
5 parashikon rreth 1.500 prova materiale në gjyq. Dhe ky është
6 një vlerësim i përafërt i cili mund të ndryshojë në varësi të
7 hapave të hetimit apo të ritmit të hetimit.

8 Sa i takon kohës, Prokuroria ka marrë parasysh dhe ka
9 marrë zotimin që të ofrojë këtë material në grupe ose
10 gradualisht dhe është e disponueshme që ta përfundojë
11 nxjerrjen e materialeve deri më 31 maj 2021, në varësi të
12 masave mbrojtëse të zbatueshme.

13 Ajo çfarë nuk mund të bëhet aktualisht është që të
14 identifikohet se cili prej nëngrupeve të materialeve do të
15 nxirret në çfarë kohe, në cilën prej kohëve të caktuara. Mund
16 të duket në vështrim të parë se p.sh., materiali i
17 paredaktuar, ose materiale që nuk kërkojnë redaktim do të mund
18 të nxirren së pari, megjithatë, në mënyrë që të identifikojmë
19 se cilat janë ato materiale të cilat kanë nevojë ose jo për
20 redaktim, do të jetë e nevojshme prej nesh që së pari të
21 përfundojmë me rishikimin e redaktimit për të gjitha
22 materialet.

23 Për pasojë materiali thjesht do të nxirret gradualisht.
24 Pra, në momentin kur ta kemi të gatshëm do t'u jepet palëve,
25 do t'i jepet Mbrojtjes, dhe do të jetë një punë e cila do të

1 jenë në progres e sipër, pra, do të bëhet gradualisht.

2 Sa i takon afatit kohor prej -- të 31 majit 2021, që u
3 përmend nga Prokuroria, kjo datë është përcaktuar në mënyrë që
4 të mund ta çojnë këtë lëndë drejt gjykimit sa më shpejt të
5 jetë e mundur. Në qoftë se ndodh kështu, ashtu siç u sugjerua
6 nga disa prej avokatëve mbrojtës, pra, që thanë që në fakt
7 nevojiten 18 muaj për të filluar gjykimin, Prokuroria do të
8 bëjë një amendim, një ndryshim të këtij afati.

9 Ndërkohë që kuadri nuk parashikon -- dhe për këtë nuk do
10 të jetë e arsyeshme gjithashtu që të kërkohen dëshmitarë
11 shtesë apo nxjerrje provash të tjera përtej afatit kohor prej
12 një viti.

13 Kaq kisha për të thënë. Faleminderit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani fjalën e ka z. Hooper.

15 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Në qoftë se
16 thonë se mund të realizojnë nxjerrjen e materialeve deri në
17 fund të majit, atëherë pse nuk e bëjnë këtë?

18 Kaq kam për të thënë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Urdhëroni z. Emerson.

21 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Përsëri jam i
22 befasuar dhe i zhgënjyer që shoh Prokurorinë se do të
23 përfitojë nga fakti që Prokuroria -- që Mbrojtja duhet të
24 kryejë hetim të hollësishëm në mënyrë që të përlligjë zgjatjen
25 e afatin për dorëzimin e materialeve që e ka për detyrë t'i

1 dorëzojë.

2 Nga ana tjetër, Mbrojtja e merr si pikënisje të hetimeve
3 të veta pikën kur Prokuroria do të përfundojë me dorëzimin e
4 materialeve. Nuk është një sjellje e përshtatshme e
5 Prokurorisë që të sugjerojë nxjerrjen e materialeve
6 paraprakisht si një objektiv të padëshirueshëm, se në këtë
7 mënyrë ia ul mundësinë Mbrojtjes, mundësinë për të hetuar.

8 Këtë po e propozon faktikisht Prokuroria kur thotë, "Po
9 ua jap 31 majin e vitit të ardhshëm si afat për dorëzimin e
10 këtyre materialeve". Pastaj thotë, "Në qoftë se Mbrojtjes i
11 duhet 18 muaj për të kryer hetimet e veta, atëherë në këtë
12 datë do të kërkojmë ta lëvizim për më vonë".

13 Unë e di, Gjykatës i nderuar, se paneli i Procedurës
14 Paraprake dhe më pas Trupit Gjykses do të garantojë që
15 Prokuroria do t'i përmbahet detyrave të veta fundamentale, që
16 është sigurimi i një gjykimi të drejtë. Mirëpo me këto
17 parashtime që i dëgjoj, e shoh si diçka të jashtëzakonshme.

18 Padyshim që Prokuroria duhet t'i përmbahet afatit që ka
19 përcaktuar, që është maji i vitit të ardhshëm, dhe pastaj ne
20 duhet të kemi periudhë të arsyeshme dhe të përshtatshme për
21 kryerjen e hetimeve tona në përputhje me artikullin 6 të --
22 nenin 6 të Konventës Evropiane, mbasi të jemi informuar për
23 hollësitë e çështjes kundër nesh dhe pasi të kemi filluar
24 hetimet dhe përgatitjen e Mbrojtjes.

25 Nuk e di se pse Prokuroria synon që t'i pamundësojë

1 Mbrojtjes një mundësi të drejtë për të vënë në testim
2 pretendimet e saj? Çfarë e justifikon një qëndrim të këtillë
3 të Mbrojtjes? Do të më interesonte të dëgjoj përgjigjen e
4 Prokurores.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.
6 Urdhëroni z. Young.

7 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Do të përpiqem
8 të jem i shkurtër.

9 Do të përdor një shprehje franceze, për arsye të
10 administrimit të përshtatshëm të çështjes duhet të jetë një
11 gijotinë në qoftë se Mbroj -- Prokurorisë i lejohet që të
12 vonojë dorëzimet e materialeve dhe të mos i japë Mbrojtjes
13 mundësi që të ndalojë, që të analizojë çështjen.

14 Ajo që do ta kisha propozuar unë, me respekt i nderuar
15 Gjykatës, është që të merrni parasysh konceptin e gijotinės
16 kur duhet t'i vihet pika ose fundi procesit të nxjerrjes së
17 materialeve, sepse në këtë mënyrë, në qoftë se vazhdojmë ashtu
18 si po shkojnë punët për momentin, atëherë do ta kemi të
19 vështirë më tej në proces.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.
21 Znj. Alagendra.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
23 Gjykatës, ne kërkuam që Prokurorisë t'i jepet data deri në 31
24 maj për dorëzimin e këtyre materialeve, sepse në këtë mënyrë
25 do t'i mundësohet më pas Mbrojtjes që të bëjë hetimet e veta

1 dhe të përgatitet për gjykim.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

3 Alagenda.

4 Tani i jap fjalën znj. Prokurore për t'iu

5 kundërpërgjigjur reagimeve të avokatëve të Mbrojtjes në lidhje

6 me nxjerrjen e materialeve.

7 Znj. Lawson keni fjalën.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për të qenë e qartë, nuk kemi

9 sugjeruar në asnjë moment se do të vonojmë me qëllim procesin
10 e nxjerrjes së materialeve.

11 Sikur thashë edhe më herët, nxjerrja e materialeve do të
12 bëhet në vijimësi duke filluar me ato materiale që janë të
13 disponueshme për t'u dorëzuar Mbrojtjes. Për atë që sugjeroi
14 z. Young, nuk duhet të zbatohet parimi i gijotinës sepse kjo
15 nuk ka kuptim në këtë çështje. Prokuroria do të përpiqet që të
16 përmbushë afatet që i janë caktuar dhe që në këtë rast janë 31
17 maj 2021.

18 Për sa i përket afateve mujore të nxjerrjes, mendoj që
19 këto nuk do të jenë të nevojshme. Sikurse thashë edhe më
20 herët, nxjerrja e materialeve do të bëhet me vijimësi, në
21 vijimësi. Ndonjëherë do të dorëzohen më shpejt, shumë përpara
22 afatit, ndonjëherë do të duhet më shumë kohë, ndoshta edhe
23 muaj. Dhe ne mendojmë që do të jetë më e përshtatshme që këto
24 afate t'i lihen në diskrecion të Prokurorisë, pra, që
25 Prokuroria të vendosë sesi do t'i dorëzojë këto materiale duke

1 u nisur nga disponueshmëria e tyre.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, ju kërkuan
3 fjalën.

4 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Po. Për
5 qëllim të procesverbalit, ajo që e tha znj. Lawson pak përpara
6 nuk është reflektim i saktë i asaj që tha më herët. Ajo që tha
7 më herët është se në qoftë se Mbrojtja pret, parashikon që
8 gjykimi të fillojë shumë më vonë se qershori i vitit të
9 kaluar, atëherë Prokuroria do të kërkojë që kjo datë, afati 31
10 maj 2021 të shtyhet për më andej. Dhe tani ajo e ndryshoi këtë
11 parashtrim në kundërpërgjigjen e vetë. Këtë e them në mënyrë
12 që të jetë e qartë se çfarë është thënë për procesverbalin.

13 Ajo që pyeta unë dhe që nuk u përgjigj Prokurorja është,
14 sepse Prokuroria po tenton kaq shumë që të vonojë përgatitjet
15 e Mbrojtjes?

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.
17 Emmerson.

18 Nuk e di në qoftë se ka ndonjë prej avokatëve diçka për
19 të shtuar?

20 Znj. Lawson, ju keni diçka për të shtuar?

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk kam i nderuar Gjykatës.
22 Besoj që parashtrimi im me sqarimin që u bë është i qartë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

24 Tani të kalojmë te materiali një qind e -- i rregullës
25 103 që ka të bëjë me materialin shfajësues.

1 Përkujtojmë Prokurorinë se e ka për detyrë që t'ia nxjerrë
2 këtë material Mbrojtjes sa më shpejt që ta ketë nën
3 kontrollin, ruajtjen apo dijeninë e vetë. Pra, bëhet fjalë për
4 materiale që mund të sugjerojnë në mënyrë të arsyeshme
5 pafajësinë e të akuzuarit ose të zbusë fajësinë e të
6 akuzuarit, apo të ndikojë në kredibilitetin apo besueshmërinë
7 e provave të Dhomave -- të Prokurorit të Specializuar.

8 Ky dorëzim materialesh është në varësi të masave
9 mbrojtëse që mund të kërkojë Mbrojtja. Më lejohet faktin që
10 Prokuroria ka ndërmend që të nxjerrë një pjesë të këtyre
11 materialeve së bashku me materialin mbështetës të Aktakuzës.

12 Fjalën ia jap Prokurores në lidhje me këtë pikë të rendit
13 të ditës.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.
15 Prokuroria do t'ia dorëzojë Mbrojtjes rreth 10.000 materiale
16 potencialisht shfajësuese jo më vonë se dorëzimi i materialeve
17 në mbështetje të Aktakuzës.

18 Ka edhe dy pyetje, çështje të tjera që dua t'ia trajtoj
19 lidhur me materialin shfajësues.

20 Për sa i përket kërkesës së Prokurorisë që t'ia hiqet
21 detyrimi i dorëzimit të informacionit që është i qasshëm për
22 të gjithë, duhet të theksojmë edhe njëherë se këtë e kemi
23 proponuar në mënyrë që të lehtësohet procedura.

24 E dyta, për sa i përket materialit, nënmaterialit të dytë
25 sipas kësaj pike, edhe ai do të dorëzohet në bazë të afateve

1 të parapara. Është vërtetuar nga jurisprudenca e gjykatave të
2 tjera si TPNJ-ja, Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën,
3 Gjykata Penale Ndërkombëtare kjo praktikë.

4 Së fundi, lidhur me kërkesës e Mbrojtjes së z. Selimi, që
5 çdo element i informacionit shfajësues të ketë referenca
6 specifike në paragrafët e Aktakuzës, një mënyrë e tillë nuk do
7 të jetë -- të bëhet nga Prokuroria. Prokuroria do t'i
8 përmbahet asaj që është paraparë në kornizën ligjore lidhur me
9 nxjerrjen e këtij materiali dhe besoj që ato tabela që do të
10 mundësohen nga Prokuroria do të jenë të mjaftueshme për
11 vlerësimin e këtij materiali shfajësues.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

13 Urdhëroni z. Hooper.

14 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Në fillim të
15 parashtrimeve të mia nuk do të them që nuk do të përsëris atë
16 që është thënë edhe më herët.

17 Kam marrë parasysh vështirësitë që kanë dalë gjatë këtij
18 procesi dhe këto materiale janë ende me Prokurorinë. Unë do
19 t'i kisha propozuar Prokurorit që të caktojnë një punonjës
20 pikërisht për këtë çështje, që do të bëjë rishikimin e këtyre
21 materialeve dhe t'i mundësojë Prokurorisë në këtë mënyrë që të
22 bëjë dorëzimin e materialeve. Dhe kjo është një përgjegjësi
23 mjaft e madhe për Prokurorinë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Urdhëroni z. Emerson.

1 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Unë kam një
2 përqasje tjetër.

3 Propozimi i Prokurorisë është i kuptueshëm për sa i
4 përket materialit që është i qasshëm, pra, publikisht i
5 qasshëm. E kam fjalën për materialet që janë nga
6 jurisprudencat e gjykatave të tjera.

7 Gjithsesi edhe pranoj propozimin se ky është një
8 reflektim i praktikave dhe të tribunaleve të tjerë, sepse ky
9 është një material që është i qasshëm dhe i disponueshëm nga
10 gjykata të tjera.

11 Për sa i përket metodologjisë së Prokurorisë, Mbrojtja e
12 z. Veseli, thekson se nuk është detyrë e Mbrojtjes që t'i
13 tregojë Prokurorisë sesi duhet ta bëjë punën e vetë. Do të
14 shikojmë sesi e ka bërë punën dhe pastaj do të paraqesim
15 komentet dhe qëndrimin e tyre, lidhur me aspekte të ndryshme
16 të detyrimeve të Prokurorisë për dorëzimin e materialeve. Dhe
17 në bazë të këtyre praktikave pastaj do të formojmë edhe
18 parashtrimet tona para kësaj Gjykate.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

20 Z. Young.

21 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Dy pika të
22 shkurtra.

23 Jam i sigurt se e kuptoni që në lidhje me materialin
24 shfajësues, Mbrojtja nuk do të sugjerojë që të ketë një parim
25 të gjyqëtorisë. Në rastin e materialit shfajësues që është mjaft

1 i rëndësishëm për të drejtat e të akuzuarit, material i tillë
2 duhet t'i dorëzohet Mbrojtjes sa më shpejt që është e mundur.

3 E dyta. Lidhur me parashtrimin tonë që është në
4 paragrafin 27 të parashtrimit tonë me shkrim, ne qëndrojmë pas
5 këtij parashtrimi. Prokuroria nuk, në fakt, kanë argumentuar
6 se përgjegjësia, dhe do ta përsëris atë që e kemi thënë në
7 parashtrimin me shkrim, ne kemi kërkuar që Prokurorisë t'i
8 kërkohet që gjatë procesit të nxjerrjes së materialit
9 shfajësues Mbrojtjes, të shpjegojë se si ai material dhe mbi
10 çfarë bazash konsiderohet shfajësues, duke u referuar
11 paragrafëve konkretë të Aktakuzës apo dëshmitarëve, apo
12 dokumenteve të tjera shkresore, provave të tjera shkresore.

13 Ne i nderuar Gjykatës, mendojmë se kjo është një mundësi
14 për -- me administrim të mirë të çështjes kur Gjykata ka
15 mundësinë të japë udhëzime në lidhje me dorëzimin e kësaj
16 kategorie mjaft të rëndësishme materiale, pra, të
17 materialeve shfajësuese.

18 Unë nuk po sugjeroj se na duhen përshkrime të holla e të
19 gjata të rëndësisë së këtij materiali, por thjesht në pika të
20 shkurtra sesi dhe mbi çfarë bazash ai material është shënuar
21 si shfajësues. Ju faleminderit z. Gjykatës.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

23 Urdhëroni znj. Alagendra.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
25 Gjykatës, ne nuk pajtohemi që Prokurorisë nuk duhet t'i

1 kërkohej që të nxjerrë materiale potencialisht shfajësuese
2 prej burimeve të hapura. Në këtë drejtim citojmë rregullën
3 103, ku thuhet se Prokurori duhet të nxjerrë menjëherë çdo
4 informacion. Pra, në këtë "çdo informacion" përfshihet edhe
5 informacioni prej burimeve të hapura.

6 Ne, për mendimin tonë, mendojmë se Prokuroria nuk duhet
7 të lirohet nga ky detyrim.

8 Gjithashtu përkrahim dhe qëndrimin që e paraqiti z.
9 Young, lidhur me këtë pikë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

11 Znj. Lawson, a keni kundërpërgjigje ndaj parashtimeve të
12 Mbrojtjes?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, përveçse të theksoj se ne
14 jemi të vetëdijshëm dhe pranojmë detyrimin tonë të nxjerrjes
15 së materialit potencialisht shfajësues. Ju faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nëse s'ka gjë tjetër për të
17 shtuar në këtë temë, tani të kaloj te rendi i ditës në lidhje
18 me materialet e rregullës 103, që ka të bëjë me materialet
19 provuese që janë thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes.

20 Desha të kujtoj Prokurorinë se nxjerrja e materialeve si
21 deklarata, dokumente, fotografi, etj., të cilat janë
22 thelbësore për Mbrojtjen, duhet të nxirren menjëherë, të
23 dorëzohen menjëherë.

24 Po kështu i kujtoj palët se mosmarrëveshjet në lidhje me
25 thelbësinë e informacionit që mund të ketë Mbrojtja, duhet të

1 dorëzohen menjëherë te Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të
2 zgjidhen.

3 Gjithashtu Prokuroria ka thënë që parashikon që do t'i
4 japë Mbrojtjes njoftim paraprak në kohë për materialet
5 provuese deri më 30 prill 2021.

6 Tani dëshiroj të dëgjoj nga Prokuroria për pozicionin e
7 tyre në lidhje me këtë çështje.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Siç e vutë në dukje ju, i nderuar
9 Gjykatës, Prokuroria parashikon që të japë njoftim për
10 materialet e rregullës 102(3) deri më 30 prill 2021, në
11 përputhje me jurisprudencën.

12 Ato që janë thelbësore për Mbrojtjen mund të
13 interpretohen në mënyrë të gjerë dhe mund të jetë një listë
14 mjaft e gjatë e materialeve që mund të përfshihen në këtë
15 kategori. Identifikimi i kësaj liste nuk mund të plotësohet
16 derisa të hartohen listat e dëshmitarëve dhe të provave
17 materiale.

18 Në përputhje me kornizën e zbatueshme dhe me njoftimin që
19 do t'i jepet Mbrojtjes, Mbrojtja duhet të kërkojë dhe të
20 identifikojë materialet që mendojnë që janë thelbësore për
21 përgatitjen e tyre. Relevanca potenciale e materialeve në bazë
22 të nenit 102(3), pra, është ajo që duhet bërë vetë nga ekipet
23 individuale të Mbrojtësve.

24 Për sa i përket parashtrimit të Mbrojtjes së z. Selimi,
25 që materialet e marra nga të akuzuarit duhet të dorëzohen

1 menjëherë, pjesa më e madhe e këtyre materialeve janë marrë
2 vetëm kohët e fundit për shkak të, ose si rezultat i
3 kontrolleve dhe sekuestimeve që janë bërë ditët e fundit.

4 Duke pasur parasysh volumin e madh të këtyre materialeve,
5 disa prej të cilave janë në formë elektronike, kurse të tjerat
6 në letër, Mbrojtja -- Prokuroria po i përpunon këto materiale
7 sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe brenda afateve kohore që
8 do të autorizohen nga Gjykatësi, ne do t'i kthejmë ose do t'i
9 asgjësojmë ato materiale që nuk janë relevante, dhe të tjerat
10 do t'i nxjerrim në përputhje me afatet kohore që përcaktova në
11 parashtrimin tim.

12 Së fundi, Mbrojtja e z. Selimi kërkoi një procedurë të
13 përcaktuar dhe një afat kohor për përpunimin e kërkesave të
14 Mbrojtjes për dorëzimin e materialeve sipas rregullës 102(3).
15 Unë desha t'i përgjigjem kësaj.

16 Ne e dimë që ndërhyrja gjyqësore mund të jetë e
17 përshtatshme në disa raste, sidomos kur ka vështirësi ose kur
18 palët nuk janë në gjendje të bien dakord me njëra-tjetrën. Por
19 kjo nuk është situata që kemi tani. Palëve duhet t'u jepet një
20 lloj diskrecioni në menaxhimin e detyrimeve të tyre për
21 nxjerrjen e materialeve në mënyrë të arsyeshme dhe efikase.
22 Dhe në fakt, në këtë fazë procesi që propozohet mund të jetë
23 kundërprodhues, kundërproduktiv.

24 Çdo ekip i Mbrojtjes duhet që të ketë materialet
25 mbështetëse dhe materialet shfajësuese që të prioritizohen, të

1 jepen sa më shpejt për ta. Procesi për secilin prej tyre do të
2 -- ky proces në qoftë se do ta bëjmë këtë për secilin prej
3 ekipeve një nga një, atëherë kjo do ta vononte shumë procesin
4 dhe do të na krijonte shumë vështirësi në procesimin e
5 kërkesave një nga një.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara sesa t'ia jap
7 fjalën Mbrojtësve, dua të pyes përkthyesit nëse janë dakord të
8 vazhdojmë edhe 10-15 minuta dhe pastaj të bëjmë një pushim.
9 Mund të më thonë, a dëshironi të bëni pushim para kësaj?

10 Përkthyesit thonë që është në rregull të vazhdojmë edhe
11 disa minuta, kështu që pushimin mund ta bëjmë përpara sesa të
12 diskutojmë procedurën për nxjerrjen e materialeve.

13 Z. Hooper keni fjalën.

14 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk kam ndonjë
15 koment për të bërë, përveç kësaj që, a mund të na jepet ne
16 transkripti i plotë i intervistës që është bërë me z. Thaçi më
17 herët në këtë vit, në 2020-ën? Faleminderit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Prokuroria do të flasë më
19 vonë, do të përgjigjet më vonë.

20 Z. Emmerson.

21 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk kam
22 ndonjë gjë thelbësore për të thënë.

23 Unë e kam thënë pozicionin tim se cili është mendimi ynë
24 për sa i përket nxjerrjes së materialeve. Pra, që duhet që
25 Prokuroria e para të kryejë obligimet e veta dhe ne e dimë

1 sesa shumë parashtrime që ka Prokuroria për të bërë dhe duhet
2 t'i jepet njëfarë kohe dhe diskrecioni për mënyrën sesi e bën
3 këtë.

4 Por siç e thashë përpara, ne rezervojmë pozicionin që të
5 shikojmë sesi do të funksionojnë gjërat në praktikë dhe pastaj
6 të japim mendimin tonë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

8 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Faleminderit.

9 Nuk kam asgjë për të shtuar, i nderuar Gjykatës, por ne i
10 përmbahemi parashtrimit që kemi bërë në paragrafin 24 të
11 materialit tonë, dhe mendojmë që ky është një propozim i
12 arsyeshëm dhe kërkojmë nga Gjykatësi që ta marrë në shqyrtim.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Ne do ta
15 rezervojmë mendimin tonë dhe do ta japim atë mbasi të shohim
16 sesi do të funksionojnë gjërat në praktikë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

18 Alagendra.

19 Znj. Lawson.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Konfirmoj që kopje të
21 transkriptit të intervistës së z. Thaçi, do të përfshihet në
22 materialet të cilat do të dorëzohet brenda afatit 30-ditor.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

24 Tani të kalojmë te materialet e mbrojtura, që janë
25 materialet e rregullës 107.

1 Në parashtim e vet, Prokurorja thotë që po kërkon
2 miratimin apo pëlqimin për sa i përket nxjerrjes së
3 materialeve në bazë të rregullës 107. Duhet të na shpjegojë
4 Prokurorja më tej se çfarë po bën në lidhje me këtë kategori
5 materialesh.

6 Znj. Lawson.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Siç e kemi thënë, ne po punojmë
8 për marrjen e miratimeve të mëtejshme. Materiali në fjalë
9 është një material që e kemi identifikuar si potencialisht
10 relevant, pra, bie në rregullën 102(3).

11 Prokuroria po punon me institucionet në fjalë. Ka 18 muaj
12 për të marrë këto miratime, dhe ne i kemi njoftuar ato për
13 afatet. Ne nuk presim që -- nuk mendojmë që marrja e këtyre
14 miratimeve do të rrezikojë afatet kohore që kemi përcaktuar,
15 prandaj parashikojmë që kërkesat do t'i bëhen Trupit Gjykses
16 në kohën e duhur. Në qoftë se do të ndryshojë ky vlerësim
17 kohor, do ta informojmë Gjykatësin menjëherë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.
19 Hooper.

20 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk kam asnjë
21 koment për të bërë. Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Emmerson.

24 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk kam gjë
25 për të shtuar.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

2 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk kam gjë për
3 të thënë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk kam
6 asnjë koment për këtë pikë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kjo pikë kaloi më shpejt
8 sesa e kisha menduar. Tani është ora 12.27. Ndoshta është më
9 mirë për përkthyesit që të bëjnë një pushim të shkurtër.

10 Do të bëjmë një pushim për 30 minuta //siç u përkthye//.

11 Pra, do të fillojmë përsëri në orën 12.40

12 --- Pushimi fillon në orën 12.27

13 --- Rifillon në orën 12.45

14 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Kalojmë tek procedura për
15 nxjerrjen e materialeve.

16 Në parashtimin e tyre Prokuroria thotë që diskutimet
17 ndërmjet palëve po vazhdojnë në lidhje me tabelën sipas
18 rregullës 109(c) por që preferon të ketë qasjen që është marrë
19 -- ndërmarrë në rastin Mustafa.

20 Po kështu vë re që disa nga mbrojtësit kanë kërkuar që të
21 bëhen tabela për secilën paketë të materialeve dhe jo një të
22 tërë për të gjithë dosjen paraprake.

23 Tani Prokuroria do të paraqesë mendimet e veta.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, përpara se sa
25 të filloj dëshiroj të them Prokurori i Specializuar Jack Smith

1 është larguar nga salla e gjyqit.

2 Në lidhje me kategorizimin e informacionit në lidhje me
3 rregullën 109(c), në përputhje me urdhrin tuaj, Prokuroria
4 filloi më 12 nëntor bisedimet me Palët duke qarkulluar një
5 propozim për secilin ekip të Mbrojtjes.

6 Ne këtë propozim e kemi bërë në bazë të praktikës që
7 është ndjekur në rastin Mustafa.

8 Nën dritën e përgjigjeve që janë marrë nga disa prej
9 ekipeve mbrojtëse, ne qarkulluam edhe një propozim tjetër të
10 hënën në mëngjes. Ne jemi në dispozicion për ta diskutuar këtë
11 temë më tutje mbi bazën e diskutimit midis palëve.

12 Megjithatë ka disa pika që duhet ti përmend tani. E para
13 është që ajo që e kam përmendur edhe njëherë përpara në këtë
14 Gjykatë por në një procedurë tjetër. Pra, kërkesa që të gjithë
15 palët sipas rregullës 109(c) do të bëhet kategorizimi për ato
16 materiale në masën që është praktike, pra, brenda burimeve dhe
17 mjeteve që janë në dispozicion.

18 Kategorizimi nuk duhet të bëhet një barrë kaq e rëndë sa
19 që të pengojë kryerjen e shpejtë të procedurave gjyqësore.

20 E dyta dhe që lidhet me këtë, formati në të cilën
21 kërkohet kategorizimi dhe koha kur duhet të bëhet kjo janë të
22 lidhura me njëra-tjetrën. Tabela e propozuar është në një
23 format që Prokuroria e ka propozuar që të jepet vetëm pasi të
24 jepet dosja paraprake. Në qoftë se do të ndryshojnë afatet
25 kohore edhe formati do të duhet të ndryshohet.

1 Së fundi, nuk ka nevojë që të ketë mjete, legjenda të
2 kësaj natyre për të lexuar materialet apo për -- që janë në
3 këto tabela. Pra, të imponosh një kategorizim d.m.th.,
4 kërkesën e kategorizimit, do të bënte që të vonoheshin dhëniet
5 e materialeve dhe kjo do të ishte kundërproduktive.

6 Por siç e thashë, ne jemi në dispozicion që t'i
7 diskutojmë me palët këto çështje mbi bazën *inter partes*.

8 Përveç kësaj, Mbrojtja e zotit Thaçi ka ngritur një
9 kundërshtim në lidhje me materialet që janë dhënë nga palët që
10 do t'i jepen Gjykatësit, sepse kjo thotë mbrojtësi i z. Thaçi,
11 do të paragjykonte klientin e tyre.

12 Prokuroria e mendon këtë çështje, pra, çështjen e aksesit
13 të Gjykatësit tek materialet, një çështje që duhet të vendoset
14 nga Gjykatësi. Ne mendojmë që është me përfitim që Gjykatësi
15 t'i marrë këto materiale; po kështu t'i marrë dhe Paneli
16 Gjyqësor që do të gjykojë çështjen.

17 Mbrojtja duket se sugjeron që një panel me gjykatës
18 profesionistë nuk do të jetë në gjendje të dallojë materialet
19 që i dorëzohen atyre nga informacionet e tjera, dhe ne nuk e
20 pranojmë këtë lloj propozimi.

21 Për sa i përket praktikës së redaktimeve, siç e thatë ju
22 i nderuar Gjykatës, kjo praktikë --

23 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Do t'ju ndërpres znj.
24 Lawson.

25 Ndoshta do të bëjmë një diskutim tjetër për sa i përket

1 praktikës së redaktimeve, por në qoftë se nuk e keni problem
2 do t'jua jap fjalën për praktikën e redaktimeve pak më vonë.

3 Të dëgjojmë nga mbrojtësit në lidhje me këtë çështje.

4 Z. Hooper, keni fjalën për sa i përket procedurës së
5 nxjerrjes së materialeve.

6 Z.HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Faleminderit.

7 Ju i keni parë parashtimet tona me shkrim. Mund t'ia jap
8 fjalën znj. Menegon e cila është e pranishme në Gjykatë, e
9 cila ka shumë më tepër përvojë sesa unë në lidhje me çështjet
10 e nxjerrjes së materialeve dhe çështjet që dalin prej tyre,
11 dhe me ta të dhënat.

12 Pra, ndoshta mund ta ftoj znj. Menegon që të shtojë diçka
13 nëse ka për të shtuar.

14 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Znj. Menegon keni fjalën.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit. Desha të theksoj
16 që kategoritë e informacionit që janë dhënë nga Prokuroria me
17 secilën paketë materialesh ne duam që çdo provë të jetë e
18 lidhur me meta të dhënat në Legal Workflow, në sistemin
19 elektronik të menaxhimit të çështjes. Pra, të lidhet secila me
20 krimet bazë, elementët kontekstualë, sjelljen e të të
21 akuzuarve etj.

22 Pra, nuk është e thënë që Prokurori të japë një tabelë të
23 veçantë për secilën paketë, por të jenë të lidhura secilat
24 prova me meta të dhënat në Legal Workflow. Dhe kjo do të na
25 lejojë ne që t'i marrim këto të dhëna në formatin që janë dhe

1 pastaj të krijojmë punën tonë.

2 Dhe pastaj kur palët të marrin dosjet paraprake, ne do të
3 na duhet një parashtrim i veçantë me të dhëna për secilën nga
4 provat e ADN-së, sepse deri tani s'kemi marrë asgjë dhe nuk e
5 dimë nuk -- e kemi të vështirë të themi se si do të ndahen
6 këto materiale në kategori, materialet që do të dorëzohen.

7 Faleminderit.

8 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Menegon.

9 Z. Emerson.

10 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Për sa i
11 përket çështjes së relevancës dhe përgatitjes së një tablele,
12 ne jemi dakord me qasjen që ka paraqitur Prokuroria. Pra, që
13 kjo nuk është më shumë se sa një mjet navigimi, pra, tabela.

14 Dhe sigurisht duhet të merret parasysh i gjithë materiali
15 në të gjithë hollësitë e veta, dhe testi këtu, për sa i përket
16 detyrimeve të Prokurorisë dhe të Mbrojtjes, duhet të jetë
17 testi i proporcionalitetit. Unë nuk kërkoj që të theksoj atë
18 që ka theksuar dhe Prokuroria, apo ato fjalët që tha për sa --
19 për aq sa është praktike në lidhje me dorëzimin e tabelave.

20 Në lidhje me kategorizimin është -- kjo nuk duhet të na
21 çojë, pra, krijimi i kësaj tablele dhe kategorizimi në vonesë
22 të procedurës.

23 Për sa i përket parashtrimin të veçantë që është bërë në
24 lidhje me z. Thaçi, ne nuk jemi dakord me atë parashtrim në
25 lidhje me materialet që do t'i jepen Trupit Gjykses. Ne kemi

1 përvoja të ndryshme. Unë kam qenë edhe vetë gjykatës në
2 Tribunalin për ish-Jugosllavinë dhe jam plotësisht dakord që
3 Tribunali të marrë në dorë materialet që do t'i japë
4 Prokuroria. Pra, nuk jam dakord me atë propozim të Mbrojtjes
5 së z. Thaçi.

6 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Zoti Young.

7 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Në lidhje me atë
8 që tha Prokuroria dhe në përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj saj.
9 I nderuar Gjykatës, kolegu im -- kolegja e Prokurorisë tha që
10 këto tabela siç i kemi propozuar ne do të jenë një barrë mjaft
11 e rëndë. Ne e pranojmë që kjo do t'i kërkojë shumë kohë
12 Prokurorisë për t'i bërë, por ne mendojmë që ne në fund të
13 fundit, në periudhën afatgjatë do të kursehet kohë duke pasur
14 këto tabela që do të jepen në vijimësi. Dhe unë do të bëj disa
15 parashtime për këtë.

16 Në faqen 10 të parashtimit tim faqja -- paragrafët 33
17 deri në 36, ne e mirëpritëm dhe e lavdëruam përpjekjen tuaj, i
18 nderuar Gjykatës, për të urdhëruar këto tabela të hollësishme
19 për nxjerrjen e materialeve.

20 Dhe përpara sesa unë të filloja të angazhohesha në këtë
21 çështje, palët kanë diskutuar një tabelë model për nxjerrjen e
22 materialeve sipas rregullës 109(c), dhe sigurisht është ajo që
23 kërkon ju që ta diskutojmë dhe ne sot për çështjen tonë.

24 Prokuroria ka paraqitur një propozim. Dhe dua ta them
25 qartë që ne jemi krejtësisht të gatshëm të angazhohemi në

1 mënyrë konstruktive me Prokurorinë në bisedime *inter partes*,
2 për të krijuar një model të përshtatshëm për këtë çështje
3 gjyqësore. Por ajo që nuk jemi dakord është propozimi i
4 Prokurorisë që ka bërë më 4 nëntor në parashtrimet e saj për
5 sa i përket rregullës 109(c), për sa i përket afateve kohore
6 që nuk janë të përshtatshme. Ata kanë thënë që do t'i japin
7 këto tabela një javë përpara dhënies së dosjes paraprake të
8 Prokurorisë.

9 Ne mendojmë që kjo nuk është e përshtatshme dhe e
10 pranueshme për ne, dhe është shumë vonë dhe ne e -- jemi
11 dakord që Prokuroria d.m.th., të bëjë përpjekje sipas
12 paragrafit 34 të parashtrimit tim që d.m.th., ka marrë
13 iniciativën për të na i dhënë këto tabela në vijimësi. Por
14 duke pas parasysh madhësinë e kësaj çështjeje dhe çështjeve që
15 do të trajtohen, ne mendojmë më shumë kohë do të kursehet në
16 qoftë se bëhet ky kategorizim që tani.

17 Dhe nuk është vetëm Mbrojtja që do të përfitonte nga kjo
18 z. Gjykatës. Prokurorët vetë do të shohin që këto tabela do
19 t'i ndihmojnë të fokusojnë mendjen, dhe palët në këtë proces
20 do të kuptojnë se çfarë rrugëtimi ka ndjekur Prokuroria në
21 dhënien e provave. Dhe në vend që të kemi një nxjerrje masive
22 të materialeve në minutën e fundit, ku të gjitha pastaj do të
23 futen në një vrimë të zezë ligjore në një kompjuter diku.

24 Është, pra, mendojmë që është e përshtatshme që sipas
25 rregullës 109 ku flitet për menaxhimin e mirë të çështjes, siç

1 e dini i nderuar Gjykatës, aty nuk jepen afatet e përcaktuara
2 kohore, por ka një test të arsyeshmërisë i cili nënkuptohet që
3 rregulla 109 të bëjë që nxjerrja e materialeve të jetë e
4 kuptimshme. Dhe këto propozimet tona janë në përputhje me
5 rregullën 109.

6 Dhe ne, siç e thamë, jemi për dorëzimin e tyre në
7 vijimësi dhe do të krijojmë -- do të bashkëpunojmë me
8 Prokurorinë për të krijuar një model që është pikërisht i
9 hartuar për këtë çështje gjyqësore. Faleminderit.

10 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Zonja Alagendra.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
12 Gjykatës, ne jemi dakord me detaje sa i takon tabelës së
13 nxjerrjes së materiale siç propozohet nga Prokuroria. Po ashtu
14 ne do të marrim pjesë dhe do të bashkëpunojmë në diskutime në
15 të ardhmen të cilat kanë të bëjnë me modelin e tabelës.

16 Por megjithatë më lejoni të shtoj që jemi në përkrahje të
17 mendimit të z. Young që janë të nevojshme disa identifikime të
18 relevancës apo rëndësisë së materialeve që do të nxirren. Këto
19 janë të rëndësishme për arsye të përgatitjes së Mbrojtjes.
20 Faleminderit.

21 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Alagendra.

22 Tani më lejoni t'i jap fjalën sërish Prokurorisë.

23 Do i kërkoj sërish zonjës Lawson se sa kohë -- për sa
24 kohë do të zgjasë ky diskutim ndërmjet palëve? Ju lutem a mund
25 të na thoni në qoftë se do jeni në gjendje, mbi bazën e

1 diskutimeve paraprake që të bini -- të keni një marrëveshje
2 ndërmjet palëve, ose në qoftë se mund të më thoni d.m.th., se
3 deri në çfarë pike të negociatës e në diskutime jeni. D.m.th.,
4 është çështje javësh apo ditësh pjesa e diskutimeve me
5 Mbrojtjen?

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit I nderuar Gjykatës.
7 Siç mund ta identifikoni edhe nga parashtrimet e bëra, besoj
8 se ka hapësirë për neve për të bërë progres sa i takon
9 marrëveshjes ndërmjet palëve.

10 Sa i takon afatit kohor, sigurisht që ky është një proces
11 që do pjesëmarrjen e të gjitha palëve, kështu do të sugjeroja
12 që ndoshta të jap një afat kohor prej një jave në qoftë se kjo
13 do të ishte e pranueshme nga Mbrojtja.

14 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit zonja Lawson.

15 Tani do të doja t'i drejtohesha Mbrojtjes, ekipeve të
16 Mbrojtjes. Do të doja t'ju pyesja në qoftë se afati kohor prej
17 një jave është i mjaftueshëm për të diskutuar me Prokurorinë
18 lidhur me tabelat apo keni nevojë për më pak kohë? Në qoftë se
19 do të donit më pak do ishte shkëlqyeshëm.

20 Fjala për ju z. Hooper.

21 Z.HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Më dëgjoni?

22 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Po ju dëgjoj mirë.

23 Z.HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Mendoj që një
24 javë është e përshtatshme. Nuk jam tërësisht i qartë lidhur me
25 atë çfarë nënkuptoni ju, i nderuar Gjykatës, kur flisni për

1 një javë. D.m.th., doni të thoni deri në fund të kësaj jave
2 apo një javë nga ky moment? Na duhet një seancë gjyqësore?

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, nuk na duhet një
4 seancë, por më duhet mua që të informohem përpara sa të
5 miratoj vendimin kuadër, vendimin kornizë për nxjerrjen e
6 materialeve.

7 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Atëherë në
8 këtë rast do thosha, neve pavarësisht që jemi të shpërndarë në
9 të gjitha vendet e mundshme dhe jemi në orare të ndryshme,
10 mendoj që kjo periudhë kohore është e mjaftueshme dhe
11 shpresojmë që të mund të përfundojë me diskutime të frytshme
12 me Prokurorinë deri të enjten e javës që vjen. Faleminderit.

13 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.
14 Z. Emmerson.

15 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Nuk mendoj që
16 na duhet kohë fare. D.m.th., unë mund të them tani, mund të
17 them përpara jush që nuk na duhet kohë fare, le të themi, për
18 t'u marrë me këtë çështje. Mendoj që është detyrimi i
19 Prokurorisë që të merret me pjesën e nxjerrjes së
20 dokumentacionit.

21 Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar përveç asaj që thashë
22 më përpara lidhur me kategorizimin. Kështu që, sipas mendimit
23 tim, ne nuk është se na duhet kohë shtesë fare për të pasur
24 diskutime të mëtejshme me Prokurorinë edhe për ta përmbyllur
25 këtë çështje të tabelave.

1 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

2 Z. Young fjala për ju.

3 Z. YANG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Jemi dakord me
4 kohën e propozuar prej një jave.

5 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Një javë
7 është e arsyeshme edhe për ne i nderuar Gjykatës.

8 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Alagendra.

9 Faleminderit shumë për punën lidhur me këtë çështje. Duke
10 pasur parasysh afatet kohore që kemi d.m.th., afatin 30-ditor
11 për nxjerrjen e dokumentacionit, më duhet të marr dy vendime.
12 Një për redaktimet ose censurimet, dhe mbase të vonoj vendimin
13 për tabelën për nxjerrjen e informacionit, sepse nuk dua të
14 vonoj le të themi, apo ta shtyj më tej afatin prej 30 ditësh
15 për sa i takon provave të nxjerra, pra, dokumentacionit
16 provues.

17 Faleminderit për komentet tuaja sa i takon tabelës.

18 Tani le të vazhdojmë te tema tjetër, le të vazhdojmë me
19 regjimin e redaktimit. Ju kërkoj ndjesë znj. Lawson që ju
20 ndërpreva pak më parë.

21 Ndërkohë që do të miratojmë një regjim redaktimi, është e
22 rëndësishme që të arrihet një balancë ndërmjet interesave për
23 të mbrojtur, le të themi, si interesat e viktimave ashtu edhe
24 të dëshmitarëve, por nga ana tjetër edhe të respektojmë të
25 drejtat e të akuzuarve.

1 Në parashtimet Prokuroria kërkon që të miratohet regjimi
2 i redaktimit që aplikohet në rastin Mustafa. Kështu që pa
3 vonesë do doja t'i jepja fjalën Prokurorisë që të shprehet
4 lidhur me regjimin e redaktimit.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit z. Gjykatës.

6 Parashtimi im lidhur me këtë çështje do të jetë shumë i
7 shkurtër. Siç është vënë re, i nderuar z. Gjykatës, një regjim
8 i tillë është identifikuar si një mënyrë efikase për të vijuar
9 më tej me proceset në mënyrë të shpejtë.

10 Edhe ky është një regjim i cili kërkon autorizim gjyqësor
11 për të gjitha redaktimet, dhe ky autorizim bëhet duke marrë
12 parasysh kategoritë edhe lloje të kufizuara të informacionit.
13 Dhe e pranojmë -- i pranojmë parashtimet që ato të bëhen me
14 shkrim.

15 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

16 Z. Hooper, fjala për ju.

17 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Ne nuk kemi
18 kundërshtim lidhur me regjimin e redaktimeve të cilat -- i
19 cili është propozuar për çështjen Mustafa.

20 I vetmi shqetësim që kam unë është ky: Nuk e di në
21 qoftë se Prokuroria e ka vënë në praktikë efektivisht këtë
22 regjim apo jo? Por në qoftë se e ka vënë, atëherë rezultatet
23 në fakt, më duhet të them, janë goxha të çuditshme, sepse do
24 të flas pak më vonë lidhur me redaktimet.

25 Dhe do thosha paraprakisht që ka redaktime të panevojshme

1 në një pjesë të mirë të informacionit që ne kemi marrë. Dhe
2 kjo është një çështje që duhet marrë parasysh nga Prokuroria,
3 sepse kjo ka ndikim mbi procesin dhe mbi progresin e punës.

4 Megjithatë, në parim ne nuk është se jemi kundër
5 përdorimit të të njëjtit regjim për redaktimin ashtu siç është
6 vendosur për çështjen Mustafa.

7 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

8 Z. Emmerson.

9 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Ajo çfarë
10 quhet regjimi Mustafa nuk asgjë më shumë dhe asgjë më pak sesa
11 identifikimi paraprakisht i kategorive të materialeve të
12 ndryshme, në të cilat mund të aplikojnë redakte. Edhe ky nuk
13 është ushtrim i komplikuar.

14 Ajo çfarë përbën një ushtrim të komplikuar është aplikimi
15 i këtyre kategorive të përgjithshme tek të dhënat në
16 deklaratat individuale. Është e paevitueshme që çdo sistem i
17 përgjithësuar që mbështetet tek kategoritë të çojë në
18 redakte të tepërta, më të tepërta se sa nevojiten. Dhe në
19 fakt na është thënë nga Prokuroria që, le të themi, dosja e
20 paragjyimit do të duhej që të rishikohej në mënyrë që të
21 hiqeshin disa prej redakteve të cilat janë vendosur më
22 përpara.

23 Dhe jam i sigurt që një proces të tillë do ta shohim edhe
24 më tej në vijimësi të procesit paragjyqësor, në qoftë se nuk
25 zgjidhet kjo çështje në kohën e duhur. Dhe nuk po sugjeroj që

1 nuk ka qenë një regjim i përshtatshëm për çështjen Mustafa.

2 Nuk po sugjeroj që nuk mund të miratohet kjo si pikë nisëse
3 për lëndën për të cilën jemi mbledhur, por duhet të marrë
4 parasysh arsyet e proporcionalitetit dhe volumi i madh.

5 Ajo çfarë duhet të dimë të pranojmë është që çfarë do të
6 bëjmë me një informacion, me një dokumentacion i cili është i
7 redaktuar më shumë sesa ç'duhet, që e bën shumë herë më të
8 vështirë për neve, ose e bën ekstremist të vështirë për
9 Mbrojtjen për të kuptuar detajet në rrethana të caktuara, apo
10 kërkon një proces të lodhshëm dhe konsumues nga koha.

11 Dhe do doja të thosha që deri tani me aq sa kemi parë,
12 pra, në qoftë se nuk ka angazhim të Prokurorisë për
13 respektimin e procesit -- të procesit të rregullt ligjor për
14 të akuzuarit, atëherë mund të rrezikojmë që të kemi një proces
15 të ngadaltë, është një proces -- të kemi një proces rezistues.

16 Dhe dua që ta them këtë gjë për procesverbal tani, sepse
17 siç mund ta shikoni pozicioni im që nga fillimi e deri tani
18 është që sigurisht që ne do duhet t'i japim kohën e nevojshme
19 e të shohim si do të funksionojë ky proces.

20 Megjithatë aktualisht nuk është se po shohim ndonjë
21 shenjë pozitive nga Prokuroria për të kalibruar, ose për të
22 pasur një lloj balance në procesin e redaktimit të praktikuar
23 dhe të zbatuar në një mënyrë që ka si shërbim kryesor
24 shërbimin e drejtësisë.

25 Dhe siç e thashë edhe në fillim fare, pra, nuk ka asgjë

1 që të akuzuarit d.m.th., mund të kenë frikë në këtë pikë por e
2 nevojshme d.m.th., që të mos të bëhen redaktime të panevojshme
3 ose të tepërta në materiale.

4 Megjithatë unë parashikoj që do të kemi goxha procese dhe
5 marrje-dhënie ndërmjet palëve, ose le të themi shkëmbime
6 ndërmjet palëve të cilat shpresoj që të çojnë në një ndryshim
7 të sjelljes. Këto parashtime kam i nderuar Gjykatës.

8 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

9 Tani përpara se t'i jap fjalën zotit Young, dua që të
10 sqaroj diçka.

11 Znj. Lawson është -- nuk është juriste e ulët e
12 Prokurorisë, por znj. Lawson është pjesë e lartë e
13 Prokurorisë. Është -- do doja që ta hiqnit, le të themi, këtë
14 cilësim dhe ta keni këtë parasysh kur t'i drejtoheni
15 Prokurorisë.

16 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Faleminderit i
17 dashur -- i nderuar Z. Gjykatës.

18 Do të doja që të thosha diçka lidhur me paragrafin 37
19 deri në 42 që ka të bëjë me procedurën për lëndën Mustafa. Dhe
20 më duhet të them që në qoftë se kemi një miratim të procedurës
21 Mustafa, është e rëndësishme ajo që Prokuroria të ketë barrën
22 e provës për të arsyetuar, le të themi, nevojën për
23 redaktimet. Dhe neve jemi në pozicionin -- në këtë pozicion,
24 pra, që i lëmë Prokurorisë barrën për të shpjeguar sepse
25 redaktimet janë të nevojshme.

1 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Znj. Alagendra.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
4 yoti Gjykatës, nuk është se e kundërshtojmë regjimin e
5 redaktimit në çështjen Mustafa. Do të doja që të mbështesja
6 pikëpamjet e z. Emmerson që u thanë pak më parë. Faleminderit

7 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Alagendra.

8 Zonja Lawson, keni ndonjë gjë për të shtuar? Keni ndonjë
9 gjë në përgjigje të asaj çfarë u tha nga ekipet e Mbrojtjes?

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me shpresë se do jetë risiguruese
11 për Mbrojtjen të dinë se asnjë prej materialeve të cilat janë
12 marrë deri më sot nuk janë redaktuar mbi bazën e këtij regjimi
13 të veçantë. Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar.

14 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Në përjashtim të rasteve kur ndonjëri prej ekipeve të
16 Mbrojtjes ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar për këtë çështje
17 do të vazhdojmë me temë -- me pikën tjetër në agjendë.

18 Në këtë pikë do të doja që t'i kërkoja palëve në qoftë se
19 ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar, për të ngritur, dhe do të
20 doja që t'u kujtoja palëve që të na njoftojnë në qoftë se
21 ndonjë nga parashtrimet e tyre do të kërkojë nxjerrjen e
22 informacionit konfidencial, në mënyrë që të marrim masat e
23 nevojshme në këtë rast.

24 Prokuroria?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

1 Faleminderit i nderuar Gjykatës.

2 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Hooper.

4 Z.HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Çështja është
5 një çështje shumë e rëndësishme duke pasur parasysh mbajtjen
6 në burgim të z. Thaçi.

7 Në seancën e parë javën që shkoi, ne e thamë qartë që nuk
8 e pranojmë as për një moment të vetëm kriteret e nevojshme për
9 burgosjen e z. Thaçi që parashikohet në nenin 41. Kështu që në
10 këto rrethana është synimi unë që të aplikojmë për lirimin e
11 tij me kusht.

12 Po ashtu, e kam sugjeruar dhe në seancën e mëparshme dhe
13 dua ta theksoj edhe sot, që modalitetet ose mënyrat sesi duhet
14 të realizohet ky ushtrim - pra, gjëja ose çështja e parë është
15 që ne duhet të kemi nxjerrje të plotë të argumenteve të cilat
16 i janë vënë në dispozicion, ju i nderuar z. Gjykatës, për sa i
17 takon urdhërarrestit në çështjen në fjalë. Unë kam marrë
18 versionin e redaktuar të Prokurorisë, të kërkesës së
19 Prokurorisë për një urdhërarrestit.

20 Edhe më duhet të them që në këtë dokumentacion ka disa
21 redakte të çuditshme. P.sh., në paragrafin 2 ne kemi -- këtu
22 thuhet te paragrafi 2 "se duke marrë parasysh nenet" pastaj
23 pjesa tjetër është e redaktuar "dhe ligjet dhe rregullat" dhe
24 pastaj kemi një pjesë të redaktuar. Nuk e di çfarë qëllimi
25 kanë, le të themi, redakte të tilla. Sipas mendimit tim,

1 redakte të tilla nuk mund të justifikohen.

2 Jo vetëm kaq, por referencat, pra, tregojnë për sjellje
3 ose keqsjellje të pretenduara në llogari të z. Thaçi gjatë --
4 përgjatë dokumentacionit. Dhe emrat e dëshmitarëve janë të
5 redaktuar në mënyrë të panevojshme, ndërkohë që një pjesë e
6 deklaratës së tyre janë të kuptuara.

7 Kështu që do doja që t'i kërkonim Prokurorit që të
8 rishqyrtojë dhe njëherë redaktimet dhe të kenë versione më pak
9 të redaktuara të këtyre dokumenteve. Dhe po ashtu, që të
10 sigurojë që të gjitha provat të jenë të cituara në fund të
11 faqes, në Fusnotat në kërkesën e Prokurorisë, dhe ky
12 dokumentacion siç duhet t'i vihet në momentin e duhur, sa më
13 shpejt të jetë e mundur, le të themi, Mbrojtjes. Edhe në qoftë
14 se është i disponueshëm, brenda tri ditësh.

15 Në momentin kur ta kemi një material të tillë dhe mendoj
16 - dhe kam folur në fakt edhe me z. Emmerson më herët këtë javë
17 - dhe neve po mendojmë për të njëjtën skemë. Sugjerojmë të
18 njëjtën skemë dhe për çdo të akuzuar, pra, të mund të merret
19 parasysh aplikimi individual ose çështja, ose le të bëhet
20 ndarja e të të akuzuarve dhe të gjenden modalitetet e
21 përshtatshme. Dhe jo vetëm të marrim modalitetet e nevojshme
22 në momentin kur këto modalitete janë përcaktuar nga
23 Prokuroria, por edhe gjatë debatit përpara jush, i nderuar
24 Gjykatës. Pra, ne të na nxirret dokumentacioni, ne të na bëhet
25 i ditur informacioni dhe ne të kemi mundësi që të përgjigjemi.

1 Kështu që në fund të ditës çështja në fakt është në përfitim
2 të parashtrimit me gojë.

3 Sa i takon parashtrimit me gojë, nuk është se do të
4 sugjeroj një datë sot, sepse do i drejtohem Gjykatës në një
5 moment tjetër kur të jemi plotësisht të përgatitur për këtë
6 çështje dhe kur të kemi një marrëveshje ndërmjet nesh. Në fakt
7 kjo është e vetmja çështje që dua të ngre.

8 Dhe mendoj që sot po ju kërkojmë z. Gjykatës - në fakt jo
9 sot po e kam fjalën në të ardhmen e afërt - që në fakt juve të
10 miratoni dhe të bini dakord për modalitetet që parashtrova më
11 sipër. Faleminderit.

12 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

13 Në çdo rast, përpara se sa të marr një vendim për këtë
14 çështje, pra, dua d.m.th., do të dua që juve që të bëni
15 parashtrimet tuaja, edhe pyetjet në seancat me gojë sigurisht
16 që do të trajtohen. Po së pari d.m.th., hapi i parë është që
17 juve të bëni parashtrimet përkatëse.

18 Hooper. Z. Hooper.

19 Z.HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
20 Gjykatës, procesi që kemi kaluar deri tani sigurisht është siç
21 e dimë, z. Thaçi është arrestuar mbi bazën e një urdhërarresti
22 i cili është miratuar prej jush dhe në këtë aspekt ne nuk
23 është se kemi -- nuk kemi ndonjë rol. Dhe unë thjesht po
24 parashtroj si një rregull të thjeshtë ndërmjet palëve që ju, i
25 nderuar Gjykatës, keni të drejtë që të dëgjoni të dyja anët.

1 Pra, ju keni dëgjuar Prokurorinë. Dhe çfarë po mundohem
2 të them është që t'i jepni mundësi atyre që të mund të jepet
3 një parashtresë e plotë e gjendjes dhe e çështjeve, në mënyrë
4 që të dimë se çfarë mund të bëhet dhe çfarë kemi përballë, sa
5 i takon juridiksionit dhe sa i takon çështjeve që ngrihen
6 kundër tij.

7 Dhe unë mund të bëj një kërkesë për juve, z. Gjykatës,
8 dhe mund të them në fakt që, le të themi, modalitetet e
9 veçanta janë këto që kërkojmë neve. Ne nuk është se e kemi
10 problem që të bëjmë parashtime të tilla me shkrim dhe
11 sigurisht që e bëjmë këtë gjë. Por nga ana tjetër nuk duhet të
12 jetë në fakt aplikimi që vjen nga ana jonë, jo në këtë fazë.

13 Dhe në fakt apo jo? Duhet ta bëj kështu si pyetje
14 retorike. Është vendi jonë për të bërë aplikim, për të bërë
15 kërkesë me shkrim në këtë fazë? Pra, ajo çfarë po kërkoj unë
16 është që të kemi njohuri të plotë plus çështjeve të tjera që
17 do të dua që të ngrejë pala tjetër, në mënyrë që neve kur ta
18 bëjmë parashtimin të jemi plotësisht të informuar për mënyrën
19 sesi qëndrojnë gjërat, dhe në mënyrë që procesi të jetë i
20 thjeshtë edhe i drejtë, dhe të dimë se ku do shkojmë në të
21 ardhmen.

22 Në të kundërtën, i nderuar Gjykatës, nuk do jemi gjë
23 tjetër veçse protagonist në këtë sistem. Dhe duke pasur
24 parasysh rregullat dhe ligjin që ka themeluar këtë Gjykatë, le
25 të themi, ligji në këtë Gjykatë, është e qartë që burgimi

1 është përjashtim, edhe në kushtet e mungesës së kriterëve
2 atëherë prezumohet lirimi. Pra, procesi është i tillë që: ne
3 të informohemi, ne përgjigjemi dhe pastaj jeni ju, i nderuar
4 Gjykatës, ai që merrni vendimin sesi të vijohet më tej.
5 Faleminderit.

6 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

7 Kam përshtypjen se thatë një gjë shumë të rëndësishme.
8 D.m.th., unë duhet që të informohem nga të dyja anët, si nga
9 Prokuroria po ashtu edhe nga Mbrojtja. Pra, pala për të cilën
10 unë nuk kam dëgjuar për këtë çështje është Mbrojtja. Dhe për
11 këtë arsye mendoj që është me vend që juve të depozitoni një
12 aplikim dhe Prokuroria t'ju përgjigjet, dhe pastaj ju mund të
13 vijoni më të dhe mund të përgjigjeni.

14 Dhe siç e thashë që nuk është se e kam mbyllur derën e të
15 dëgjuarit për këtë çështje dhe këtë kërkesë, sepse mendoj se
16 sa më shumë diskutime të ketë ndërmjet palëve aq më mirë
17 është. Por më duket se në bazë të kornizës ligjore së pari
18 juve duhet që të bëni një kërkesë për lirim me kusht, në
19 mënyrë që të mund të vijohet më tej me këtë proces.

20 Në qoftë se Prokuroria nuk ka diçka tjetër për të thënë
21 lidhur me këtë, atëherë duhet t'ia jap fjalën z. Emmerson.

22 Urdhëro zoti --

23 Znj. Lawson.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të përgjigjem pasi t'i kem
25 dëgjuar parashtimet gojore të gjithë avokatëve mbrojtës.

1 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Sa më lajmëruan që ju zoti
2 Hooper keni thënë diçka por e keni pasur të ndalur - jo të
3 ndezur mikrofonin. A mund ta përsëritni edhe një herë atë që e
4 keni thënë?

5 Z. Hooper e keni të fikur mikrofonin. Tani ju dëgjojmë.
6 Besoj që nuk doni ta dëgjoni të gjithë atë që e thashë
7 përpara. Do të përsërit atë gjënë e fundit që e thashë në fund
8 të parashtimit paraprak dhe mendoj që ajo që nuk e dëgjuat
9 ishte. Faleminderit.

10 Urdhëroni z. Emmerson.

11 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Ka nuanca
12 ndryshimi midis meje dhe z. Hooper për nga mendimi, por në
13 përgjithësi janë parashtime të ngjashme.

14 Për dallim nga z. Thaçi, Prokurori ka dëgjuar
15 parashtimet në emër të z. Veseli përpara se të merrte
16 vendimin lidhur me mënyrën sesi do të sillej z. Veseli para
17 kësaj Gjykate. Para disa javëve -- disa javë përpara fillimit
18 të procesit unë i shkrova z. Smith duke i paraqitur në hollësi
19 sesa -- sepse z. Veseli duhet të -- pse z. Veseli duhet t'i
20 besohet për pikën e dorëzimit vullnetar.

21 Dhe kam kënaqësinë të them se ky proces çoi në një
22 bashkëpunim dhe u krye shumë paraprakisht dhe të aktit të
23 arrestimit. Unë nuk e kam të qartë edhe sot e kësaj dite në
24 qoftë se kjo letër që është shkëmbyer midis meje dhe
25 Prokurorisë ju është treguar juve si Gjykatës? Nuk jam i

1 sigurt për këtë sepse Prokuroria vetë si rezultat i kësaj
2 letre filloi negociatat me mua lidhur me dorëzimin vullnetar
3 të z. Veseli.

4 Pra, lidhur me këtë pikë kemi një fillim, të thuash,
5 bashkëpunues midis palëve, dhe ne do të bëjmë paraqitjet tona
6 për lirim të përkohshëm të z. Veseli. Dhe të gjitha këto që
7 kanë ndodhur paraprakisht nga të dy palët, besojmë që do të
8 merren parasysh në vendimin e Gjykatës.

9 Për sa i përket procedurës unë jam në duart tuaja, si të
10 thuash, Gjykatës, për sa i përket urdhrave për parashtrime me
11 shkrim dhe mënyrën se si duhen të bëhen ato. Në paragrafin 15
12 të parashtrimit që kam bërë do t'i dëgjoni -- do t'i lexoni
13 ato kushtet që i paraqes unë. Dhe do të lexoni se mënyra sesi
14 zyrtarisht z. Veseli e ka kërkuar lirim të përkohshëm deri në
15 fillim të gjykimit paraqitet në atë paragraf, duke e ftuar
16 Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të caktojë një orar apo
17 kohët për shkëmbimet e parashtrimeve me shkrim midis palëve.

18 E kam të qartë qasjen e avokatit të z. Thaçi për sa i
19 përket arsyeve të arrestimit, por kjo është një pyetje
20 krejtësisht tjetër nga ajo e lirimit të përkohshëm. Do të ketë
21 shumë çështje që duhet të jenë të përbashkëta, mirëpo ju tani
22 keni një të akuzuar përpara jush, e keni kornizën ligjore
23 brenda të cilës mund të nxirrni vendime tuaja, dhe kjo kornizë
24 ligjore mundëson që të merren parasysh të gjitha dispozitat e
25 tjera të jurisprudencave të tjera dhe neni 5 i Konventës

1 Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2 Barra ligjore për justifikimin e paraburgimit i takon
3 Prokurorisë. Prokuroria duhet të vërtetojë në mënyrë të saktë
4 sesi do të tejkalohet një rrezik me anë të mbajtjes së të të
5 akuzuarit në paraburgim deri në fillimin apo dhe përfundimin e
6 këtyre procedurave.

7 Pra, në këtë situatë nuk jemi duke i trajtuar tani
8 konkretisht për pikën e lirimit të përkohshëm se përmbi çfarë
9 arsyes është arrestuar z. Thaçi apo z. Veseli. Pyetja që
10 parashtrohet tani është si vijon: A duhet Gjykata të miratojë
11 lirimin e përkohshëm?

12 Sikurse thashë, barra e vërtetimit i takon Prokurorisë.
13 Mbrojtja pastaj u përgjigjet parashtimeve të Prokurorisë dhe
14 kundërshtimeve të Prokurorisë për lirim të përkohshëm. Kërkesa
15 e z. Veseli është bërë paraprakisht me shkrim në këtë
16 procedurë dhe tashmë është protokolluar.

17 Kaq kisha lidhur me këtë pikë.

18 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.
19 Emmerson.

20 A do ta kishe të vështirë që të bësh një parashtim të
21 veçantë lidhur me këtë pikë?

22 Nuk e kam për qëllim që të ngadalësojmë procedurën, por
23 thjesht dua që të qartësohem se çfarë vendimi duhet të merret,
24 se çfarë procedure duhet të ndiqet për këtë?

25 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Do ta bëj

1 këtë padyshim dhe në pika shumë të shkurtra, por më lejoni që
2 ta them këtë tani.

3 Kërkesa do të thotë thjesht që z. Veseli po bën kërkesë
4 për lirim të përkohshëm me këto kushte, dhe ju do të keni
5 pastaj një kohë të shkurtër si palë që t'i përgjigjeni
6 kërkesës.

7 E kam të qartë që Prokuroria ka marrë një farë pozite apo
8 qëndrimi, si të thuash, model që të kundërshtojë pa dhënë
9 mundësinë për të rikonsideruar edhe një herë atë qëndrim të
10 vetin.

11 Pra, padyshim që do ta bëj kërkesën në formë të shkruar,
12 dhe në këtë parashtrim do ta them vetëm atë që është
13 thelbësore me përjashtim në qoftë se marr udhëzime të tjera
14 prej jush si Gjykatës i Procedurës Paraprake. Në qoftë se ky
15 proces që propozoj është jo i pranueshëm për ju, atëherë ju
16 lutem të ma bëni me dije. Ju faleminderit Gjykatës.

17 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Emmerson.

18 Mbaj shënim të gjitha që i thatë dhe do të fillojmë nga
19 ajo pikë.

20 Urdhëroni z. Young.

21 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Në pika të
22 shkurtra do ta them këtë. Sa më shpejt që të jetë e mundshme
23 do ta bëjmë kërkesën tonë për lirimin e përkohshëm të z.
24 Selimi.

25 Kur ju, i nderuar Gjykatës, do t'i keni përpara të gjitha

1 faktet lidhur me situatën apo rrethanat e z. Selimi, mendoj që
2 ju do të merrni vendimin e duhur.

3 I nderuar Gjykatës, z. Selimi është një njeri me
4 integritet, i ndershëm dhe që përmbush detyrimet e tij. Ai
5 bashkëpunoi në bazë vullnetare me Prokurorinë kur mësoi për
6 Aktakuzën e Konfirmuar. Kur u kërkua që të ishte këtu në Hagë
7 më 5 nëntor ai u paraqit dhe ka bashkëpunuar gjatë gjithë
8 kohës me Gjykatën. I nderuar Gjykatës, ndoshta ju këtë nuk e
9 dini se ai u ftua për të qenë i pranishëm në Hagë në vitin
10 2019 dhe e bëri këtë, erdhi vullnetarisht.

11 Lidhur me Prokurorinë dhe parashtrimet e saj se z. Selimi
12 është rrezik i arratisjes, një parashtrim i tillë është
13 absurd. Ne do të kërkojmë nga Prokuroria në ditët që vijojnë
14 të nxjerrë materiale dhe informacion që ka të bëjë
15 drejtpërsëdrejti me pranitë e mëparshme të z. Selimi në Hagë,
16 me bashkëpunimin prej anës së tij në të kaluarën, me
17 ndërveprimin e tij me autoritetet.

18 Sikurse tha edhe z. Hooper, duam që përpara se të bëjmë
19 kërkesën për lirim të përkohshëm të jemi plotësisht të
20 përgatitur dhe në mënyrë që t'ju ndihmojmë edhe ju që të
21 merrni vendimin mbi bazën e themelësisë së kërkesës.

22 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
24 Gjykatës, dua t'ju them që z. Krasniqi nuk iu dha mundësia që
25 të dorëzohej vullnetarisht. Po që se do t'i ishte dhënë kjo

1 mundësi ai do ta bënte këtë.

2 Ne do të bëjmë kërkesë me shkrim lidhur me lirin e
3 përkohshëm të z. Krasniqi, dhe më pas do të presim përgjigjen
4 e zotit - e Prokurorit. Ju faleminderit.

5 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Shoh që kërkon fjalën z.
6 Hooper.

7 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] I nderuar
8 Gjykatës, ju e dini se z. Thaçi dha dorëheqjen nga posti i
9 Presidentit të Kosovës që të bashkëpunojë me këtë Gjykatë. Ai
10 gjithashtu edhe iu dorëzua vetë në bazë vullnetare
11 autoriteteve të Kosovës në Kosovë dhe pastaj u soll në Hagë.

12 Për sa i përket vetë kërkesës, padyshim që përfitova nga
13 diskutimi që zhvilluat ju me z. Emmerson, dhe besoj që në
14 mënyrë të ngjashme edhe ne sot do të bëjmë një kërkesë, si të
15 thuash, të përgjithshme për lirim të ndërkohshëm të z. Thaçi
16 me kushtet që i kërkon Gjykata.

17 Dhe do ta bëjmë këtë në pritje se kërkesës tonë do t'i
18 kundërpërgjigjet Prokuroria dhe do t'i paraqesë mendimet e
19 veta, argumentet e veta, në lidhje me z. Thaçi. Dhe më pas,
20 pasi të ketë marrë përgjigjen e Prokurorisë, Mbrojtja e z.
21 Thaçi do t'i kundërpërgjigjet asaj përgjigjeje. Dhe në qoftë
22 se ka nevojë do të mbahen dhe diskutime apo seanca dëgjimore
23 për t'i trajtuar edhe më tej këto parashtrime.

24 Besoj që kam kuptuar si duhet qasjen që morët ju dhe z.
25 Emmerson.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Hooper.

2 Nuk më takon mua që t'ju tregoj se çfarë të përfshini e
3 çfarë jo në një kërkesë dhe çfarëdo që të jetë ajo, por unë
4 pres parashtimet prej jush.

5 Znj. Lawson, a keni diçka për të thënë në përgjigje të
6 parashtimeve të mbrojtësve?

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

8 Lidhur me kërkesën për vetë fletarrestimet, atyre u bënë
9 redakte me kujdes në mënyrë që të mbroheshin dëshmitarë
10 individualë. Për më tepër sugjerimi se Prokuroria e ka
11 trajtuar jo në mënyrën e duhur të akuzuarin, është një
12 keqinterpretim i parashtimeve që i kemi bërë ne.

13 Për sa i përket materialeve që përmenden në kërkesën,
14 sikurse i kemi njoftuar mbrojtësit me e-mail të hënën, një
15 paketë materialesh po përgatitet dhe do t'u dorëzohet deri në
16 fund të kësaj jave.

17 Qëndrimi i Prokurorisë është se nuk ka ndryshuar
18 rrethanat për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të të
19 akuzuarve.

20 Në qoftë se ekipet e Mbrojtjes duan ta kundërshtojnë këtë
21 qëndrim të Prokurorisë, qoftë me anë të paraqitjes së
22 kërkesave për lirim të përkohshëm apo me anë të kërkesave të
23 tjera, atëherë procedura që ndiqet është përshkruar qartë në
24 rregullën 57.

25 Ne kundërshtojmë propozimin që ekipet e Mbrojtjes të

1 parashtrojnë, si të thuash, një parashttrim të përgjithshëm për
2 lirim të përkohshëm. Parashttrimet e palëve duhet të përfshijnë
3 pika të hollësishme ligjore dhe të provës.

4 Në qoftë se ekipet e Mbrojtjes duan të kundërshtojnë
5 mbajtjen në paraburgim, atëherë duhet ta paraqesin këtë
6 qëndrim me hollësi duke i mbuluar të gjitha argumentet e tyre
7 në parashttrimet me shkrim. Dhe ju më pas, i nderuar Gjykatës,
8 pasi që të keni parë të dy -- dhe shqyrtuar vështrimet e të dy
9 palëve, të merrni vendimet e duhura.

10 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

11 Urdhëroni z. Emmerson.

12 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Përpara sesa
13 të përgjigjet z. Hooper, ndoshta ka pasur një keqkuptim nga
14 znj. Lawson se çfarë u propozua.

15 Sigurisht sugjerimi nuk është që të bëhet një aplikim
16 skelet që ndiqet pastaj nga një seancë gojore. Po duke qenë se
17 barra e provës është -- i takon Prokurorisë, atëherë duhet të
18 paraqesin ata argumentet e tyre substantive thelbësore, sepse
19 Mbrojtja nuk mund të paraqesë parashttrimet e veta pa e ditur
20 qorrazi, pa e ditur se në çfarë mbështetet Prokuroria.

21 Pra, është e arsyeshme që të ndiqet kjo procedurë. Kjo
22 është një prezumim. Nuk ka prezumim në favor të mbajtjes së
23 tyre në paraburgim. Prezumimi është për lirin e tyre.

24 Ju kërkuat që ne si palë të dorëzojmë parashttime për
25 arsye procedurale veç secili, dhe pastaj Prokuroria mund t'i

1 përgjigjet dhe të japë kundërshtimet e veta. Dhe pikërisht
2 kësaj i referohet znj. Lawson.

3 Ajo që po përpiqet të arrijë znj. Lawson, është që
4 Mbrojtja t'i vendosë të gjitha kartat mbi tryezë që në fillim
5 dhe pastaj Prokuroria t'i përgjigjet atyre. Kurse sugjerimi
6 jonë është që çfarëdo forme që do të marrë ky proces, unë jam
7 i hapur për sugjerimet tuaja, i nderuar Gjykatës, substanca
8 është çështje që do të vendoset në bazë të ligjit dhe barra e
9 provës i takon Prokurorisë.

10 Pra, ne duhet të kemi fjalën e fundit. Ne duhet të kemi
11 fjalën e fundit mbasi ta marrim vesh se çfarë kundërshtimesh
12 ka Prokuroria për lirimin e tyre. Në rastin e z. Veseli dhe
13 Thaçi, Prokuroria ka shkelur rregullat. Që në qershor, që kur
14 ka shpallur se ka dorëzuar një aktakuzë kundër z. Thaçi dhe
15 kundër z. Veseli në atë kohë, megjithëse në atë fazë nuk ishte
16 konfirmuar akoma.

17 Pra, këto rregulla u shkelën në mënyrë shumë të qartë,
18 dhe si pasojë e kësaj z. Veseli dhe Thaçi, e kanë ditur që në
19 qershor se ata janë objekt i një aktakuze. Në këto rrethana,
20 që Prokuroria të thotë që i takon atyre, pra, të akuzuarve që
21 të paraqesin Mbrojtjen e tyre përpara, dhe pastaj Prokuroria
22 të japë përgjigjen e vet, kjo është gabim në thelb dhe në
23 parim.

24 Në mënyrë që të kemi një procedurë të rregullt duhet që
25 të paraqesim me shkrim kërkesën tonë, por kjo s'ka nevojë të

1 jetë më tepër sesa thjesht për të kërkuar të drejtën e lirimit
2 të përkohshëm. Dhe ne mendojmë që kështu duhet trajtuar kjo
3 çështje.

4 Arsyeja që ndërhyra tani është sepse zonja Lawson u
5 përgjigj një sugjerimi që ne nuk e kemi bërë, dhe ajo duhet
6 t'i përgjigjet vetëm sugjerimeve që i bëjmë ne, jo sugjerimeve
7 që nuk janë bërë.

8 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.
9 Z. Hooper.

10 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Ne jemi dakord
11 me këtë procedurë. Kjo është procedura më e drejtë dhe më e
12 përshtatshme për t'u ndjekur.

13 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Znj. Lawson keni diçka për
14 të shtuar?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

16 Nuk është ashtu që Mbrojtja do t'i bëjë qorrazi
17 parashtimet e veta, pa e ditur se çfarë argumentesh ka
18 Prokuroria. Ne i kemi dhënë atyre aplikimin mbi bazën e të
19 cilit është bërë fletarrestimi dhe mbi bazën e të cilit është
20 marrë dhe vendimi i Gjykatësit.

21 Po kështu, ashtu siç tha edhe avokati i zotit Veseli, i
22 takon Mbrojtjes të ketë fjalën e fundit. Ne s'kemi asnjë
23 kundërshtim kundër kësaj. Dhe faktikisht është dhe procedura e
24 duhur për t'u ndjekur që Mbrojtja të bëjë aplikimin e vetë
25 substantiv, Prokuroria të përgjigjet dhe pastaj Mbrojtja t'i

1 përgjigjet Prokurorisë. Dhe pastaj mund të bëhen edhe
2 paraqitje gojore në një seancë gojore.

3 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Emmerson.

5 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] E përsëris,
6 duket se kemi një keqkuptim të madh nga ana e Prokurorisë.

7 Pozicioni kur Prokuroria shkeli rregullat dhe shpalli
8 ekzistencën e një informacioni konfidencial, pra, një aktakuze
9 që ishte dorëzuar gjykatësit, ata në deklaratën e tyre publike
10 përdorën si justifikim se ata donin ta bënin këtë publike,
11 sepse ishin bërë përpjekje nga z. Veseli dhe z. Thaçi për të
12 penguar procedurat, dhe nuk janë dhënë - nuk është dhënë asnjë
13 shpjegim për këtë apo hollësi.

14 Siç e shpjegoi z. Hooper, ky informacion është redaktuar
15 nga fletarrestimi që na është dhënë.

16 Pra, është e vetëkuptueshme dhe s'ka nevojë që të kesh
17 arsyetim madhor për t'i kuptuar këto gjëra. Nuk ka asnjë lloj
18 kundërshtimi ndaj lirimit të përkohshëm të z. Thaçi dhe z.
19 Veseli mbi bazën e mosparaqitjes së tyre. Kjo nuk do të jetë
20 çështja që do të diskutohet. Çështja është nëse këta dy të
21 pandehur do të ndikojnë apo do të ndërhyjnë në procesin e
22 drejtësisë. Dhe kjo është ngritur nga Prokuroria. Kjo ndoshta
23 mund të ngrihet prej tyre dhe në të ardhmen.

24 Thelbi që është përmendur në deklaratën e Prokurorit kur
25 shkeli rregullat në qershor, na është dhënë ne vetëm në formë

1 të redaktuar. Dhe në asnjë situatë nuk na është dhënë thelbi
2 se cila është arsyeja e vërtetë dhe pse duhet të rrinë ata në
3 paraburgim.

4 D.m.th., rreziku i arratisjes nuk ekziston, rreziku i
5 mosparaqitjes nuk ekziston. E vetmja pyetje që e ngre
6 Prokuroria është që ka pasur ndërhyrje të paligjshme në
7 rrjedhën e drejtësisë që justifikon konkluzionin që duhet të
8 mbahen gjatë gjithë kohës në paraburgim sepse kjo do t'i
9 pengojë ata që të ndërhyjnë te dëshmitarët. Ky është një
10 propozim i pakuptimtë.

11 Ata nuk na e kanë dhënë informacionin mbi të cilin e
12 bazojnë këtë pretendim, atëherë si mund të bëjmë ne një -- të
13 paraqesim një parashtrim kuptimplotë në qoftë se nuk e kemi
14 informacionin? Pra, kjo është një lloj loje që po luan
15 Prokuroria në interesin e arritjes së një procedure që kërkon
16 z. Smith, i cili tani është larguar nga seanca, nuk është
17 këtu.

18 Për sa i përket Mbrojtjes, ne do të dorëzojmë një aplikim
19 skelet dhe Prokuroria duhet t'i përgjigjet në një mënyrë që
20 artikulon në mënyrë realiste dhe në mënyrë të hollësishme
21 arsyet sepse këta të katër të akuzuarit duhet të qëndrojnë në
22 burg, pavarësisht se prezumohen të pafajshëm në rrethanat kur
23 --

24 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, ne më duket po
25 futemi në sferën e aplikimit që po bëni.

1 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Jo, jo.
2 Prokuroria po ju sugjeron që Mbrojtja duhet të dorëzojë një
3 dosje të detajuar me të gjithë materialet ku mbështeten ato
4 për një çështje thelbësore, kur ne nuk e dimë se çfarë
5 kundërshtimesh kanë ata për lirimin e tyre. Kjo është mungesë
6 e një procedure të drejtë të cilën po kërkon z. Smith, znj.
7 Lawson dhe z. Tieger.

8 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

9 Nëse palët nuk kanë gjë tjetër për të thënë për këtë
10 çështje tani -- ah, znj. Lawson.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

12 Unë desha që ta lë këtë, të kaloj, por duke pasur
13 parasysh që avokati i z. Veseli vazhdon të përsërisë akuzën që
14 Prokuroria ka shkelur rregullat, dua ta bëj shumë të qartë që
15 nuk ka qenë kështu, dhe çdo hap që ka ndërmarrë Prokuroria ka
16 qenë me autorizimin e përshtatshëm dhe të duhur.

17 Së dyti, aplikimi për këtë flamurin që po tund z.
18 Emmerson, është një flamur fals. Ky aplikim për fletarrestimin
19 e secilit prej të të akuzuarve i është dhënë secilit mbrojtës,
20 dhe aty jepen arsye të bollshme që justifikojnë mbajtjen e
21 tyre në paraburgim.

22 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Emmerson shumë shkurt.

23 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Unë do
24 përgjigjem, nuk do ngre çështje të re.

25 Znj. Lawson sapo tha publikisht dhe në procesverbal për

1 akuzimin e paligjshmërisë së deklaratës së z. Smith në
2 qershor, duke thënë se kjo nuk ishte në përputhje -- nuk ishte
3 në kundërshtim me ligjin sepse është bërë me autorizimin e
4 duhur.

5 Kjo deklaratë nuk mund të lihet të kalojë kështu pa dhënë
6 komente tona. Çfarë autoriteti ka pasur? Ka qenë autoritet
7 gjyqësor? A ka qenë autoritet ekzekutiv? Mbi çfarë bazash
8 është bërë? Sepse rregullat janë shumë të qarta. Sepse në
9 qoftë se dikush në sistem mendon që mund të shkelë rregullat
10 dhe të marrë përsipër gjëra që nuk i takojnë me ligj, atëherë
11 Mbrojtja duhet ta dijë se kush është ky person?

12 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Ka ndonjë tjetër, ndonjë
13 palë tjetër diçka për të thënë në lidhje me këtë?

14 Znj. Lawson? Jo.

15 Atëherë i kërkoj palëve të me japin mendimet e tyre për
16 një datë të përshtatshme për Konferencën tjetër për Ecurinë e
17 Çështjes. Vë re në këtë drejtim që mbrojtësit e të akuzuarve,
18 në qoftë se ata duan të marrin pjesë me anë të videolidhjes,
19 duhet që të informojnë Zyrën Administrative 24 orë
20 paraprakisht në mënyrë që të merren masat e duhura për të
21 organizuar lidhjet me video. Po kështu këto njoftime që do t'i
22 bëhen Zyrës Administrative duhet të kenë pëlqimin me shkrim të
23 të akuzuarve.

24 Organizimi i videokonferencave me disa të akuzuar nga
25 distanca kërkon shumë përgatitje, dhe ju lutem palëve që ta

1 respektojnë këtë proces për Konferencat e ardhshme të Ecurisë
2 - për Ecurinë e Çështjes.

3 A mund të na jepni palët datat që mendoni që janë të
4 përshtatshme për konferencën e ardhshme?

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë parashtim të
6 veçantë për këtë. Ne për momentin po plotësojmë, po përmbushim
7 detyrimet tona për nxjerrjen e materialeve, megjithatë jemi në
8 dispozicion kurdo që të dojë Gjykata.

9 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Z. Hooper.

10 Z. Hooper s'keni mikrofon. Z. Hooper përsëri s'keni
11 mikrofon.

12 Z. HOOPER: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Varet nga
13 objektivat që do të plotësohen apo gjërat që do të diskutohen
14 për të justifikuar kryerjen apo mbajtjen e një seance apo
15 Konferencë për Ecurinë e Çështjes. Megjithatë mund të them
16 diku nga mesi i dhjetorit mund ta bëjmë një seancë të tillë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

18 Z. EMMERSON: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Diku nga mesi
19 i dhjetorit duket e arsyeshme, por unë -- nuk duhet që kjo të
20 paragjykojë seancën për aplikimin për liri me kusht. Kjo mund
21 të jetë edhe më përpara.

22 Z. YOUNG: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Në mes të
23 dhjetorit është në rregull.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes/Përkthim] Mesi i
25 dhjetorit është i arsyeshëm edhe i përshtatshëm, përveç

1 aplikimit që do të bëhet për lirim të përkohshëm që ne do ta
2 dorëzojmë më përpara.

3 GJYKATËSI GULLOU: [Përkthim] Sapo më thanë që mikrofon
4 im ishte i fikur.

5 Përpara sesa t'i jap fund kësaj seance, desha t'i
6 informoj palët që kur të kërkohen parashtime prej tyre për
7 çdo temë ata, mund të dorëzojnë parashtime për t'u
8 protokolluar nëse dëshirojnë.

9 Kjo -- me kaq e mbyllim seancën e sotme.

10 Falënderoj përkthyesit, stenografin, teknikët audiovizual
11 edhe personelin për asistencën e tyre.

12 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundon
13 në orën 13.54

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25